



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 301 Akti

Nr. 391 Vendimi
Tiranë, më 26.5.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 21.5.2021, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Desart Avdulaj**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi z. Desart Avdulaj në seancën dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Desart Avdulaj, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Desart Avdulaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Brunilda Bekteshi dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues të trupit gjykues, komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Desart Avdulaj, bazuar vetëm në kriterin e rivlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit mbi kriterin e pasurisë, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi afatin për të sjellë prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në datën 2.3.2021, brenda afatit të përcaktuar, subjekti i rivlerësimit Desart Avdulaj, depozitoi shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, të cilat u administruan dhe analizuan nga trupi gjykues.

7. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Desart Avdulaj, në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 21.5.2021, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 21.5.2021, ora 9:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj, si edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre, për të vazhduar në datën 26.5.2021, me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

A. VLERËSIMI I PASURISË

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm me konkluzionin se në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Desart Avdulaj:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/1. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

10. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

11. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e këtij subjekti dhe personave të lidhur me të, nga ku ka rezultuar si vijon:

1. Apartament me sipërfaqe 169,8 m², në “**”, Tiranë**

12. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* apartamentin e banimit, i cili është porositur me kontratën e porosisë nr. ***, datë 8.10.2015, në vlerën 101.880 euro, ndërsa si burim të krijimit ka deklaruar: (a) kursime të ruajtura në banesë gjatë viteve në vlerën 31.880 euro; dhe (b) hua të marra nga persona fizikë në shumën 70.000 euro.

13. Subjekti ka bashkëlidhur me deklaratën *Vetting*, kontratën e porosisë nr. ***, datë 8.10.2015, midis tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për apartamentin me sipërfaqe totale 169,8 m², kundrejt çmimit 101.880 euro, si dhe kontratën e shitblerjes¹ nr. ***, datë 29.7.2016, midis të njëjtave palë për këtë apartament. Çmimi i shitjes së pasurisë është 101.880 euro, ku palët deklarojnë se janë likuiduar tërësisht sipas kontratës së porosisë në datën 8.10.2015 dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit.

14. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: “porosi apartament në Tiranë, ‘****’, sip. 169,8 m², me kontratën e porosisë, datë 8.10.2015, në shumën 101.880 euro. Paguar e gjithë shuma me këste në datat 8 dhe 23 tetor, 6, 13 dhe 26 nëntor, si dhe 4 dhe 21 dhjetor në ‘Tirana Bank’, me burim të krijimit: (i) kursime të ruajtura në shtëpi gjatë viteve; (ii) hua marrë nga persona fizikë”.

15. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: “... përfundim të kontratës së shitjes së datës 29.7.2016, për blerje apartament në Tiranë, ‘****’, sip. 169,8 m². Paguar shuma 101.880 euro, me kontratën e porosisë, datë 8.10.2015”.

¹ Kontrata midis “****” dhe Desart Avdulaj, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së nr. 4/1.

16. Në lidhje me kohën e pagesës së kësteve dhe shumat përkatëse të paguara, subjekti i rivlerësimit², ndër të tjera, ka deklaruar se pagesat për shoqërinë janë kryer në datat 8.10.2015, 23.10.2015, 6.11.2015, 13.11.2015, 26.11.2015, 4.12.2015 dhe 21.12.2015, duke dërguar edhe mandatet përkatëse bankare, konkretisht:

Datë	Shuma/euro	Mënyra e transferimit	Përshkrimi
8.10.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës, kursime
23.10.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës
6.11.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës
13.11.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës
26.11.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës
4.12.2015	10.000	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap. sipas kontratës
21.12.2015	41.900	Dep. cash në llogari të shoq.	D. Avdulaj, pag. blerje ap, depoz. J. A.
Totali	101.900		

17. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “Sa i përket burimeve të të ardhurave për blerjen e apartamentit, sqaroj se kanë qenë: (a) kursime të ruajtura në shtëpi datë 31.12.2014, gjendje cash shuma 6.100.000 lekë (deklaruar në DPV-të për vitet 2003 - 2014); (b) hua të marra nga persona fizikë: datë 21.4.2015, J. A. më ka dhënë cash shumën 20.000 euro (deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.4.2015); datë 18.5.2015, Gj. A. derdh në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ shumën 15.000 GBP; datë 26.6.2015, A. K. ka kaluar në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ shumën 20.000 euro; datë 8.9.2015, K. A. derdh në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ shumën 10.000 euro. Vetëm pasi unë kisha siguruar të gjithë shumën e nevojshme për blerjen e apartamentit në Tiranë, me sip. 169,8 m², kam lidhur kontratën e porosisë nr. ***, datë 8.10.2015, për blerjen e këtij apartamenti dhe kam paguar me këste në datat 8 dhe 23 tetor, 6, 13, 26 nëntor dhe 4, 21 dhjetor 2015, të gjithë vlerën e apartamentit”.

Analizë e burimit të deklaruar

Hua të marra nga personat fizikë si burim krijimi

18. Në formularët mbi detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizike, si dhe të dhëna konfidenciale, pjesë e deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- hua e marrë për blerje apartamenti nga vëllai J. A. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar në datën 21.4.2015 (3.4.2015³), me burim të ardhurat nga paga;
- hua e marrë për blerje apartamenti nga shtetasi A. K. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar në datën 2.7.2015, me burim të ardhurat nga paga;
- hua e marrë për blerje apartamenti nga vëllai K. A. në shumën 10.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 8.9.2015, me burim të ardhurat nga paga;
- hua e marrë në datën 18.5.2015, nga kushëriri Gj. A. në shumën 15.000 GBP, pa interes, me afat 10-vjeçar, me burim të ardhurat nga paga.

² Përgjigje të pyetësorit nr. 2.

³ Deklaruar në të dhëna konfidenciale deklarata *Vetting*.

19. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”⁴ rezulton se: (i) në datën 26.6.2015 është transferuar nga shtetasi A. K. në llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit në euro, shuma 20.000 euro me përshkrim “dhënie huaje”; (ii) në datën 9.7.2015 është tërhequr nga kjo llogari shuma 10.000 euro, nga shtetasi J. A. ; (iii) në datën 8.9.2015 është depozituar nga shtetasi K. A. shuma 10.000 euro, me përshkrimin “derdh dhënie huaje”; (iv) në datën 11.12.2015 është depozituar shuma 12.000 euro nga shtetasi J. A., me përshkrimin “janë tërhequr GBP dhe janë këmbyer” (në llogarinë nr. *** në GBP në emër të subjektit në datën 18.5.2015 është kredituar shuma 15.000 GBP nga shtetasi Gj. A., në datën 23.6.2015 është tërhequr nga shtetasi J. A. shuma 6.000 GBP, ndërsa në datën 10.12.2015 është tërhequr shuma 9000 euro); (v) në datën 17.12.2015 është tërhequr *cash* nga shtetasi J. A. shuma 12.000 euro; (vi) në datën 21.12.2015 është tërhequr *cash* nga shtetasi J. A. shuma 20.000 euro.

Hua nga shtetasi J. A.

20. Në deklaratën *Vetting*⁵, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar edhe *huan e marrë për blerje apartamenti nga vëllai J. A. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 21.4.2015, me burim të ardhurat nga paga.*

21. Në DPV-në e vitit 2015, në formularin mbi detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka deklaruar *hua në shumën 20.000 euro për blerje apartamenti në datën 21.4.2015, nga personi fizik J. A, me afat 10-vjeçar, pa interes.*

22. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.4.2015⁶, shtetasi J. A. deklaroi se i ka dhënë hua të vëllait Desart Avdulaj, në datën 3.4.2015, shumën 20.000 euro, pa interes dhe me afat deri në datën 3.4.2025.

23. I pyetur lidhur me mënyrën e marrjes së kësaj shume dhe destinacionin e saj më pas (nisur nga diferenca në kohë e deklarimit të marrjes së shumës hua nga vëllai J. A., me datën e pagesës së kësaj të parë të çmimit të blerjes së apartamentit në ***), subjekti i rivlerësimit⁷, ndërmjet të tjerash, ka deklaruar se: *“Sa i përket huas prej 20.000 euro nga vëllai im J. A., rezulton se kjo shumë është marrë dorazi nga ana ime. Destinacioni i kësaj huaje ka qenë për blerje apartamenti. Edhe pse apartamenti që unë kam vendosur të blej ka filluar të paguhet në datën 8.10.2015, unë para kësaj periudhe kam kërkuar të blej/porosit apartament ku ka qenë më e favorshme për mua sa i përket vendndodhjes, sipërfaqes dhe çmimit për m². Huan e marrë nga vëllai Jetlir e kam mbajtur në shtëpi së bashku me të tjera kursime të mia ndër vite deri në momentin që të gjeja një mundësi të favorshme për blerjen e një apartamenti”*.

24. Pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënieje, kanë detyrimin për të*

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020.

⁵ Formularët mbi detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, si dhe të dhëna konfidenciale.

⁶ Dosja e ILDKPKI-së (Aneks nr. ***).

⁷ Përgjigje të pyetësorit nr. 3.

justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Kjo dispozitë kërkon konfirmimin e personit tjetër të lidhur për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së dhurimit apo huas”.

25. Në formularët mbi detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, si dhe të dhëna konfidenciale, pjesë e deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *hua e marrë për blerje apartamenti nga vëllai J. A. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar në datën 21.4.2015 (3.4.2015⁸), me burim të ardhurat nga paga.*

26. Për të provuar burimin e deklaruar të të ardhurave të vëllait J. A., subjekti ka depozituar në dosjen e ILDKPKI-së si dokumentacion provues: (i) vërtetim, datë 26.10.2016, nga shoqëria “****” sh.p.k., për të cilat ka përfituar dividend, në vitin 2013 shumën 287.517 lekë dhe në vitin 2014 shumën 255.000 lekë; (ii) vërtetim page në datën 26.10.2016, nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi J. A. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., në pozicionin e përmbaruesit gjyqësor privat, nga 6.4.2013 – 25.5.2015. Për periudhën prill – dhjetor 2013 ka pasur pagë *bruto* në shumën 500.000 lekë dhe pagë *neto* në shumën 439.345 lekë, ndërsa për periudhën janar 2014 – maj 2015 pagë *bruto* në shumën 100.000 lekë dhe *neto* në shumën 80.163 lekë; (iii) deklaratë individuale të të ardhurave për vitin 2013 të shtetasit J. A. (datë deklarimi 30.4.2014).

27. Nga sa më sipër subjekti në deklaratën *Vetting* ka përcaktuar të ardhurat nga paga, si burim krijimi për shumën prej 20.000 euro, të dhënë hua atij me deklaratën noteriale të datës 21.4.2015, ndërsa dokumentacioni shoqëruar i depozituar përfshin edhe të ardhurat nga ortakëria e huadhënësit në shoqërinë “****” sh.p.k., duke shtuar burimet e të ardhurave të vëllait për dhënien e kësaj huaje.

28. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur edhe vërtetimin e datës 7.8.2020 nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi J. A. ka qenë punonjës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të “Raiffeisen Bank”, për periudhën 3.12.2008 – 31.3.2013 dhe ka përfituar të ardhura *neto* në vlerën 5.053.215 lekë.

29. Referuar faqes *online* të QKB-së, rezulton se me kontratë shitjeje kuotash, datë 3.4.2013⁹, shtetasi J. A. ka blerë nga ortaku i vetëm A. K. 3% të kuotave të kapitalit (në vlerën 300 lekë) të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, ndërsa në datën 20.4.2015 janë shitur kuotat te shtetasi A. K. në vlerën 300 lekë.

30. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁰ konfirmon se nga shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT ***, për periudhën 2010 – 2015 është shpërndarë shuma prej 28.386.450 lekësh në formë dividendi, për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse tatimore, nga të cilat Komisioni vlerëson se për 3% të kuotave të kapitalit huadhënësi shtetasi J. A. (vëllai i subjektit) ka përfituar nga shpërndarje dividendi vlerën *neto* prej 415.310 lekësh¹¹.

⁸Deklaruar në të dhëna konfidenciale deklarata *Vetting*.

⁹Aprovuar ndryshimi në QKB në datën 5.4.2013.

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020.

¹¹Analizuar edhe më poshtë tek dividendi i shpërndarë i shoqërisë “****” sh.p.k.

31. Referuar vërtetimit të paraqitur nga subjekti¹², vëllai i tij, për periudhën 3.12.2008 – 31.3.2013, nga marrëdhëniet e punësimit në “Raiffeisen Bank” ka përfiturar të ardhura *neto* në shumën 5.053.215 lekë.

32. Nga të dhënat e “Raiffeisen Bank”¹³ në llogarinë bankare në lekë në emër të huadhënësit, rezulton se për vitin 2013 janë transferuar, ndër të tjera, këto vlera monetare nga shoqëria “****” sh.p.k., si dhe janë kryer këto tërheqje *cash*, në mënyrë periodike, në vlera të konsiderueshme pas transferimit të pagës nga kjo shoqëri.

Datë	Shuma e kredituar - lekë	Shuma të tërhequra - lekë
23.5.2013	439.755	datë 24.5.2013, tërheq <i>cash</i> 300,000 lekë
20.6.2013	439.755	datë 24.6.2013, tërheq <i>cash</i> 300,000 lekë
23.7.2013	439.755	datë 25.7.2013, tërheq <i>cash</i> 320,000 lekë
22.8.2013	439.755	datë 23.8.2013, tërheq <i>cash</i> 320,000 lekë
25.9.2013	439.345	datë 30.9.2013, tërheq <i>cash</i> 350,000 lekë
24.10.2013	439.345	datë 25.10.2013, tërheq <i>cash</i> 320,000 lekë
2.12.2013	439.345	datë 3.12.2013, tërheq <i>cash</i> 320,000 lekë
Total	3.077.055	

33. Nga analizimi i dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, në kuadër të këtij hetimi administrativ, konkretisht nga të dhënat nga “Union Bank”¹⁴ rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., për periudhën 2012 – 2015, nga llogaria e saj në lekë ka transferuar periodikisht vlera monetare për shtetasin C. M., me përshkrim “pagë/shpërbliim/dieta”, njëkohësisht nga ky shtetas ka depozitime *cash* në llogari të shoqërisë në mënyrë periodike, në të njëjtën ditë apo disa ditë më pas (të shumës së transferuar në formë page), në të njëjtën shumë apo të ndonjë vlere të përafërt.

34. Në bazë të informacionit marrë nga “Raiffeisen Bank”, se në datën e pretenduar të dhënies së huas (më 3.4.2015), shtetasi J. A. (huadhënësi, vëllai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur të pashlyera tri kredi bankare pranë kësaj banke, konkretisht: (i) kredinë disbursuar në datat 25.8.2011 dhe 26.9.2011, në shumën totale 55.000 euro; (ii) kredinë disbursuar në datën 3.11.2011, në shumën 200.000 lekë; (iii) kredinë, disbursuar në datën 11.4.2014, në shumën 416.000 lekë dhe vetëm dy muaj pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimit), për shlyerjen e dy kredive në lekë, ka përdorur një kredi tjetër (konsumatore me hipotekim) të marrë në datën 12.6.2015 në “Raiffeisen Bank” në shumën 1.750.000 lekë.

35. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti, ndër të tjera, shpjegon se: “*Sa i takon shumave të përmendura nga ju, vëllai im J. A. parashtron këtë sqarim: ...këto shuma janë tërhequr për t’u konvertuar në monedhën euro dhe një pjesë e tyre ka shkuar për pagesë kredie ndërsa pjesa tjetër për t’u kursyer. Kreditë e marra kanë pasur qëllim për konsumatore, pra, nuk kanë qenë kredi me qëllim të caktuar. Janë marrë në momente kur i janë dashur për arsye personale. Këto të ardhura, por edhe të ardhura në vitet 2014-2015 kanë shërbyer, ndër të tjera, edhe për dhënien e huas kundrejt meje në shumën 20.000 euro*”.

¹²Përgjigje të pyetësorit nr. 2.

¹³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.10.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2020.

36. Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni, kredia është disbursuar në dy pjesë, në datat 25.8.2011 dhe 26.9.2011. Shlyerja e saj është kryer sipas përcaktimeve në kontratë, me përjashtim të datës 28.3.2013, në të cilën është shlyer një principal në shumën 8.632 euro. Pra, shlyerja para kohe e një pjese të principalit të kredisë ka ndodhur përpara fillimit të transferimit të pagës nga shoqëria përmbarimore “****” sh.p.k., ndërsa për periudhën e punësimit në këtë shoqëri pagesat e kësteve të kredisë në euro kanë qenë në shumën 180-200 euro/muaj.

37. Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacionin e disponuar në lidhje me pagesën e kësteve të kësaj kredie.

38. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se nga aktet e administruara në dosje, deklaratimet e subjektit dhe kronologjia e ngjarjeve ekonomike lidhur me pagat e transferuara për shtetasin J. A. në “Raiffeisen Bank” nga shoqëria për vitet 2013 dhe 2014¹⁵, tërheqjet periodike prej tij pa destinacion të qartë pas transferimit të pagës, praktikës së ndjekur nga kjo shoqëri edhe me punonjës të tjerë, situatës financiare të huadhënësit në kohën e dhënies së huas lidhur me detyrime/kredi/overdraftet të pashlyera të këtij shtetasi, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka arritur të provojë burimin e krijimit për shumën e dhënë hua nga shtetasi J. A. ¹⁶.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

39. Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... e rëndësishme është që të provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave në raport me shtimin e burimit ku Komisioni vë theksin. Jam përpjekur që të sjell dokumentacion ligjor me të ardhura të ligjshme të personit të lidhur për të përmbushur mundësinë e dhënies së huas”....Sipas analizës sime rezulton se personi tjetër i lidhur ka realizuar vetëm me të ardhura nga paga, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, për periudhën prill 2013 – prill 2015 shumën prej 5.422.182 lekësh, e cila përfshin shumën prej 20.000 euro të dhënë hua subjektit të rivlerësimit...

Fakti se personi i lidhur në datën 3.4.2015 ka pasur ende për të shlyer kredi apo overdraftet, nuk përbën ndalim ligjor që të më jepte mua huan prej 2.800.000 lekësh. Pavarësisht se në deklaratat noteriale afati i shlyerjes ka qenë 3 prill 2025, ai konsiderohet afat maksimal dhe unë nuk kam pasur pengesë që të mund të shlyeja huan edhe më parë afatit maksimal...”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

40. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

41. Në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruar, Komisioni ka evidentuar fakti se subjekti nuk ka qenë konsekuent në gjithë deklaratimet e tij, në deklaratën e pasurisë së

¹⁵Ndryshim në ulje me gati 5 herë në vitin 2014, në krahasim me vitin 2013.

¹⁶Duke mos përfshirë në analizën paraprake financiare shumën prej 20.000 euro (në formën e huas nga vëllai J. A. në vitin 2015 – për të cilën nuk është justifikuar plotësisht burimi i të ardhurave).

rivlerësimit, në deklaratat periodike të interesave, si dhe në deklaratimet gjatë hetimit administrativ, lidhur me burimin e krijimit të huas marrë nga vëllai e tij.

42. Komisioni vlerëson se vetëm fakti që një burim fitimi/marrëdhënie juridike huaje është deklaruar në deklaratat/t periodike dhe në dokumente zyrtare, të cilat në themel bazohen në thënie të njëanshme, nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e burimit në sasinë apo rrethanat e deklaruara.

43. Subjekti ka treguar kujdes të deklarojë një burim të caktuar, pavarësisht nga mungesa e dokumentacionit të plotë shoqërues-provues që duhet të përmbushi kriteret e kërkuara nga ligji lidhur me ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje.

44. Në lidhje me të ardhurat nga paga për huadhënësin, nga shoqëria “****” sh.p.k., Komisioni vlerëson se mbështetur në dokumentacionin e disponuar mbi pagat e transferuara për shtetasin J. A. në “Raiffeisen Bank” nga shoqëria për vitet 2013 dhe 2014, subjekti nuk arriti të provojë: (i) destinacionin e saktë të vlerave monetare të tërhequra *cash* periodikisht pas transferimit të pagës (praktikë e ndjekur nga kjo shoqëri provuar nga hetimi administrativ edhe me punonjës të tjerë); (ii) mundësinë për kursim të personit tjetër të lidhur vëllait të tij.

45. Sa më sipër situata faktike e dokumentuar i krijoi bindjen trupit gjykues lidhur me mosekzistencën e këtyre të ardhurave.

46. Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk mund të shërbejnë për të provuar ekzistencën e burimit të ligjshëm të huas dhënë prej tij, pasi vërtetësia e thënieve nuk konstatohet e provuar dhe sepse nga analiza e të gjithë dinamikës dhe elementeve përbërëse të shtjelluar, në mënyrë kritike dhe në tërësi me gjithë elementet e tjera çojnë Komisionin në konkluzionin se argumentet e paraqitura nga subjekti bien në kundërshtim me dokumentacionin e disponuar në dosje, duke krijuar dyshime të për vërtetësinë e deklaratimeve mbi marrëdhënien financiare të kësaj shoqërie dhe personit tjetër të lidhur, shtetasit J. A.

47. Situata financiare e huadhënësit në kohën e dhënies së huas lidhur me detyrime/kredi/*overdraft*e të pashlyera të tij, si dhe faktit se vetëm dy muaj pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimit, për shlyerjen e dy kredive në lekë, huadhënësi ka përdorur një kredi tjetër (konsumatore me hipotekim) të marrë në datën 12.6.2015 në “Raiffeisen Bank” në shumën 1.750.000 lekë, gjithashtu, krijuan bindjen e trupit gjykues mbi pamundësinë financiare të huadhënësit për dhënien e kësaj huaje.

48. Shpjegimet e subjektit dhe faktet e cituara më sipër, vlerësuar së bashku si pjesë përbërëse e detyrimeve të subjektit për të deklaruar plotësisht dhe saktësisht pasuritë në pronësi dhe në përdorim, si dhe burimet e ligjshme të tyre, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, çuan trupin gjykues në konkluzionin se subjekti nuk ka provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit J. A. (vëllai), për dhënien e shumës prej 20.000 euro në datën 3.4.2015.

Hua nga shtetasi A. K.

49. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndërmjet të tjerash, edhe *hua e marrë për blerje apartamenti nga shtetasi A. K. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 2.7.2015, me burim të deklaruar të ardhurat nga paga.*

50. Në DPV-në e vitit 2015, në formularin mbi detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti deklaron: *hua në shumën 20.000 euro për blerje apartamenti në datën 2.7.2015, nga personi fizik A. K., me afat 10-vjeçar, pa interes.*

51. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.7.2015, shtetasi A. K. deklaron se i ka dhënë hua nëpërmjet transfertës bankare në “Raiffeisen Bank” shtetasit Desart Avdulaj shumën 20.000 euro, pa interes dhe me afat deri në vitin 2025.

52. Në llogarinë rrjedhëse në euro, nr. 0025834564, në emër të shtetasit A. K., e cila ka pasur balancë në vlerën 25.922.06 euro, në datën 26.6.2015 është depozituar *cash* shuma 20.000 euro nga shtetasi A. K., me përshkrimin “nga biznesi zyrtë përmbartimor”, dhe në të njëjtën ditë është transferuar shuma 20.000 euro në llogari të shtetasit Desart Avdulaj, me përshkrimin “dhënie huaje”. Pas këtyre veprimeve në llogarinë në euro, nr. ***, në emër të shtetasit A. K. gjendja në datën 31.12.2015 është 35.519 euro.

53. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndodhur para një marrëdhënieje të konfirmuar të huas, subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi tjetër i lidhur/A. K., kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhënë hua.

54. Për të provuar burimin e deklaruar të të ardhurave të shtetasit A. K., subjekti, në dosjen e ILDKPKI-së, ndër të tjera, ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetim, datë 5.12.2016, nga shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet të cilit vërtetohet se ortakut A. K. ka përfituar të ardhura personale në formë dividendi për periudhën 2011 – 2016, në shumën *neto* 51.074.964 lekë; (ii) vërtetim page, datë 5.12.2016, nga shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi A. K. ka realizuar të ardhura nga paga si përfaqësues i kësaj shoqërie për periudhën 2010 – 2016.

55. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka përcaktuar të ardhurat nga paga, si burim për shumën prej 20.000 euro, të dhënë hua me deklaratën noteriale, datë 21.4.2015, por dokumentacioni shoqëruar përfshin edhe të ardhurat nga ortakëria në shoqërinë “****” sh.p.k.

56. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁷ konfirmon se nga shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, për periudhën 2010 – 2015, është shpërndarë shuma prej 28.386.450 lekësh në formë dividendi, për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse tatimore.

57. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2017, DRT-ja Tiranë informon ILDKPKI-në se shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, ka deklaruar dividend për periudhën 2010 – 2015 në vlerë totale 11.796.785 lekë.

58. Nisur nga të dhënat e ndryshme nga ana e këtij institucioni lidhur me fitimin *neto*, dividendin dhe tatimin përkatës të deklaruar/paguar nga kjo shoqëri, iu kërkua përsëri informacion DRT-së Tiranë dhe DPT-së, në lidhje me: vlerën e saktë të fitimit *neto* të deklaruar/llogaritur; vlerën e saktë të dividendit të shpërndarë, duke u shoqëruar me

¹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020.

vendimin e asamblesë përkatëse; si dhe vlerën dhe kohën e tatimit të paguar mbi dividend për llogari të administratës tatimore për periudhën 2010 – 2015¹⁸.

59. Në përgjigjen e saj në lidhje me dividendin, DRT-ja Tiranë¹⁹ është shprehur se: “Nga verifikimi rezulton se subjekti ‘***’ sh.p.k., me NIPT ***, për periudhën 2011 – dhjetor 2014, ka bërë shpërndarje të fitimeve të viteve të mëparshme dhe tërheqje dividendi për shumën 76.954.770 lekë, si dhe ka paguar tatim në burim mbi dividendin shumën 7.695.477 lekë (bashkëlidhur pasqyra e pagesës së dividendit, printuar nga kontabiliteti deri në dhjetor të vitit 2014, llogari e cila është mbajtur jashtë sistemit informatik). Nga verifikimi në arshivë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se për periudhën e mësipërme subjekti ka depozituar vetëm vendim të asamblesë së ortakëve, datë 23.6.2014 (bashkëlidhur vendimi). Sipas sistemin C@TS, për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015, subjekti ‘***’ sh.p.k., me NIPT ***, ka bërë shpërndarje të fitimeve dhe tërheqje dividendi në shumën 10.000.000 lekë dhe ka paguar tatim në burim mbi dividendin në shumën 1.500.000 lekë...”.

60. Referuar përgjigjeve të ndryshme, të pasqyruar në tri shkresa nga DRT-ja Tiranë lidhur me dividendin e shpërndarë dhe tatimin në burim të deklaruar/paguar nga shoqëria “****” sh.p.k. për periudhën 2010 – 2015, si dhe mbështetur në legjislacionin²⁰ e zbatueshëm (përfshirë edhe statutin²¹ datë 23.9.2010, të kësaj shoqërie),

61. Komisioni vlerëson se në kushtet kur shpërndarja e dividendit në shoqërinë tregtare kryhet mbi një vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, të cilat kanë detyrim ligjor depozitimin e këtyre vendimeve pranë organeve tatimore jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, dhe organi përgjegjës tatimor, DRT-ja Tiranë, referuar shkresës nr. *** prot., datë 5.1.2021, nuk ka të dokumentuar/administruar dhe përcjellë pranë Komisionit të gjithë vendimet përkatëse të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., si të vetmit dokumente ligjore të shoqërisë mbi bazë të të cilave miratohen rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe caktohet destinacioni i fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi, për rrjedhojë, edhe evidentimi i shumës së dividendit të shpërndarë, kontabilizimi i detyrimeve, pagesave, si dhe rakordimi i shumës përkatëse të tatimit në burim mbi dividendin të deklaruar/paguar nga autoriteti tatimor²², duket se nuk është i plotë dhe i saktë.

62. Në vlerësim të fakteve më sipër, Komisioni mori në konsideratë për efekt të pasqyrimin të të ardhurave në formë dividendi të ortakëve nga shoqëria “****” sh.p.k., vendimet e asamblesë dorëzuar nga kjo shoqëri në Qendrën Kombëtare të Biznesit²³, konkretisht:

¹⁸Kërkesë nr. *** prot., datë 11.12.2020, e Komisionit.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 5.1.2021.

²⁰Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1 “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit”; ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, pjesa IV “Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar”, neni 76, pikat 1 dhe 81.

²¹Në statutin, datë 23.9.2010, të shoqërisë “****” sh.p.k., në pikën 12 “të drejtat e asamblesë” është përcaktuar se: “... 3. Vetëm asambleja e ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë: (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërisë, si dhe shpërndarjen e fitimit...”.

²²Referuar shkresës nr. *** prot., datë 5.1.2021.

²³Referuar faqes online të QKB-së, protokolluar në Komision, përkatësisht nr. *** prot., datë 17.2.2021: (i) vendim nr. *** , datë 13.6.2011, i asamblesë së ortakëve (nr. *** prot.), pika 2 – fitimi i shoqërisë “****” prej 110.583 lekësh të shpërndahet për dividendë; (ii). vendim, datë 22.6.2012, i asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë, A. K., për shqyrtimin

63. Sa më sipër, shuma e dividendit të deklaruar të shpërndarë, sipas vendimeve të asamblesë të depozituara në QKB, deri në datën 31.12.2015 është në vlerën 26.492.454 lekë²⁴. Kësaj shume i përket një tatim në shumën prej 3.149.245 lekësh.

64. Si përfundim, shuma *neto* e dividendit të përfituar nga ortakët e kësaj shoqërie deri në datën 31.12.2015, është 23.343.209 lekë, nga e cila shuma prej 415.310 lekësh është përfituar nga ortaku J. A. dhe shuma prej 22.927.899 lekësh nga ortaku A. K..

65. Referuar dokumentacionit të disponuar²⁵, shuma e të ardhurave të huadhënësit llogaritet në vlerën prej ofro 46.353.956 lekësh (përfshi të ardhurat nga dividenti i dokumentuar i shpërndarë).

Investime të tjera, përfshirë dhe vlera monetare, huadhënie të evidentuara nga ky shtetas

66. Në bazë të dhënave financiare/bankare, rezulton se: (i) në llogarinë rrjedhëse në euro, në emër të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, në datën 26.6.2015 është transferuar nga shtetasi A. K. shuma 20.000 euro, me përshkrimin “dhënie huaje”; (ii) në “Raiffeisen Invest”²⁶ në datën 7.5.2015, shtetasi A. K. ka investuar në blerje të kuotave në shumën 15.000.000 lekë, të cilat kanë qenë gjendje edhe në datën 31.12.2015; (iii) në datën 7.7.2014 në “Raiffeisen Bank”²⁷, ky shtetas i ka dhënë hua bashkëshortes shumën prej 82.656 euro.

67. Referuar të dhënave të ILDKPKI-së²⁸, deklaruesi D. K. deklaroi në DPV-në e vitit 2015 se i ka marrë hua djalit A. K.: shumën 11.107.000 lekë (për blerje apartamenti), hua e filluar në datën 22.12.2012 (e palikuiduar deri në datën 31.12.2015); si dhe shumën 12.666.000 lekë (për blerje njësi shërbimi, Tiranë), hua e filluar në datën 11.6.2013 (e palikuiduar deri në datën 31.12.2015). Në deklaratën e interesave private të vitit 2015 të personit të lidhur, djali A. K., në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, ndër të tjera, ka deklaruar: dhënie huaje pa interes shtetasve A. S. dhe R. S., në shumën 5.800.000 lekë; dhënie huaje pa interes, me afat kthimi 10 vjet, shtetasit Desart Avdulaj, në shumën 20.000 euro; dhënie huaje pa interes, me afat kthimi 10 vjet, bashkëshortes Th. K., në shumën 7.200.000 lekë; si dhe nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë në datën 31.12.2015.

e situatës financiare të shoqërisë, si dhe ndarjen e fitimeve të realizuara gjatë vitit 2011, vendosi: “...pika 3. Të shpërndajë në formë dividendi vlerën prej 1.000.000 lekësh...”; (iii) vendim, datë 18.6.2013, i asamblesë së ortakëve të shoqërisë, A. K. dhe J. A., për shqyrtimin e situatës financiare të shoqërisë, si dhe ndarjen e fitimeve të realizuara gjatë vitit 2012, vendosi: “... pika 3 – të shpërndajë në formën e dividendit vlerën prej 4.733.078 lekësh, duke paguar 473.308 lekë tatim dividendi...”; (iv) vendim, datë 23.6.2014, i asamblesë së ortakëve të shoqërisë, A. K. dhe J. A., për shqyrtimin e situatës financiare të shoqërisë, si dhe ndarjen e fitimeve të realizuara gjatë vitit 2013, vendosi: “... pika 3. – të shpërndajë në formën e dividendit vlerën prej 10.648.793 lekësh, duke paguar 1.064.879 lekë tatim dividendi...”; (v) vendim, datë 26.6.2015, i asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë, A. K., për shqyrtimin e situatës financiare të shoqërisë, si dhe ndarjen e fitimeve të realizuara gjatë vitit 2014, vendosi: “... pika 2. – të shpërndajë në formë dividendi vlerën prej 6.837.155 lekësh... pika 3. – gjithashtu ta shpërndajë në formën e dividendit nga vlera e rezervave të mbartura shumën 3.162.845 lekë. Totali që do të shpërndahet si dividend do të jetë 10.000.000 lekë, për të cilin do të paguhet 15% tatim në burim, ose 1.500.000 lekë...”.

²⁴Afërsisht sa vlera e dividendit të shpërndarë të pasqyruar në shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2020, të DRT-së Tiranë.

²⁵ (i) të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, për periudhën 2008 – 2010, të ardhurat nga paga të transferuara në këtë bankë në llogari të shtetasit A. K., rezultojnë në vlerën 2.667.668 lekë. Të ardhura nga interesat në depozitat në “Raiffeisen Bank” (vitet 2011 – 2015), në shumën 1.466.168 lekë; në ABI Bank (vitet 2011 – 2012) në shumën 62.570 lekë dhe në “Raiffeisen Invest” (vitet 2012 – 2013), në shumën 393.666 lekë; (ii) shkresë kthimi përgjigje nr. *** prot., datë 23.12.2020 e Arkivit Qendror të Sigurimeve, në të cilën paga mbi të cilën paguhen kontributet për vitin 2011 rezultoi në vlerën 960.000 lekë (80.000 lekë*12); (iii) vërtetimet nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 24.8.2020, të DRT-së Tiranë, në të cilat të ardhurat *neto* nga pagat e z. A. K. për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2015, rezultojnë në vlerën 17.875.985 lekë.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2019.

²⁷Llogaria rrjedhëse nr. *** në euro.

²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020.

68. Sa më sipër, në datën 31.12.2015, shtetasi A. K: (i) ka deklaruar likuiditet në formë huadhënieje, të pakthyera deri në datën 31.12.2015, në shumën 36.773.000 lekë + 20.000 euro; (ii) ka investuar në datën 7.5.2015 në “Raiffeisen Invest” shumën 15.000.000 lekë, e pakthyer deri në datën 31.12.2015; (iii) ka gjendje në llogarinë në euro në “Raiffeisen Bank” shumën 35.519 euro, si dhe në llogarinë depozitë në lekë në “Raiffeisen Bank” shumën 1.541.957 lekë; si dhe (iv) dokumentohet dhënia e një huaje bashkëshortes në shumën 82.656 euro në datën 7.7.2014, me transfertë në “Raiffeisen Bank”.

69. Komisioni, sa më sipër referuar të ardhurave të huadhënësit, si dhe gjendjes së huadhënieve të tjera dhe investimeve të kryera, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit, sa duket se subjekti dhe personi i lidhur, shtetasi A. K., nuk kanë justifikuar me burime të ligjshme shumën 20.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2015²⁹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

70. Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Sipas analizës sime rezulton se personi tjetër i lidhur ka realizuar vetëm me të ardhura nga paga si përfaqësues i shoqërisë ‘***’, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, për periudhën janar 2012 – qershor 2015, shumën prej 17.875.985 lekësh, e cila përfshin shumën prej 20.000 euro të dhënë hua subjektit të rivlerësimit ose 2.809.600 lekë, konvertuar në datën e dhënies së huas. Në këtë kuptim për të konkluduar nëse shumën e dhënë hua personi tjetër i lidhur kishte mundësinë ta ruante, duhet të zbritet nga shuma prej 17.875.985 lekësh, që janë të ardhurat e tij (janar 2012 – qershor 2015) shuma prej 612.708 lekësh, e cila është shuma e analizuar si shpenzim jetik bazik për personin tjetër të lidhur për të njëjtën periudhë. Në përfundim të kësaj analize, rezulton se personi tjetër i lidhur kishte mundësi të kursente shumën prej 17.263.277 lekësh. Në këtë rast, duke qenë se nuk e ka marrë në konsideratë Komisioni, vlerësoj se duhet marrë në konsideratë edhe një hua që personi i lidhur e ka kontabilizuar në bilancin e vitit 2014 në shumën 24.396.188 lekë, në zërin ‘të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve’. Dhe llogaritur edhe këtë hua që ortakë ka marrë, vlerësoj se përsëri mbulohet shuma e huas që personi i lidhur më ka dhënë në datën 26.6.2015”.*

71. Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka depozituar në cilësinë e provës, ndër të tjera, edhe kontratë huaje (shkresë e thjeshtë) të datës 15.12.2013, midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit A. K. (administrator i saj) për dhënien e një huaje në vlerë 32.773.000 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

72. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

²⁹Duke mos përfshirë në analizën paraprake financiare shumën prej 20.000 euro (në formën e huas nga z. A. K. në vitin 2015 – për të cilën nuk është justifikuar plotësisht burimi i të ardhurave).

73. Shtetasi A. K. (person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit), ka qenë deklarues si person i lidhur i një subjekti deklarues (babait të tij) pranë ILDKPKI-së³⁰, duke filluar nga viti 2013, për këtë Komisioni, në analizën e mundësisë financiare të këtij shtetasi për dhënien e huas në vitin 2015, është mbështetur edhe në deklaratimet periodike vjetore të dorëzuara në këtë institucion.

74. Në lidhje me huan e pretenduar të marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 24.396.188 lekë³¹, për të cilën subjekti ka depozituar në cilësinë e provës në seancën dëgjimore kontratën e huas të datës 15.12.2013 (shkresë e thjeshtë), midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit A. K. (administrator i saj), është përcaktuar se huadhënësi (shoqëria “****” sh.p.k.) i ka dhënë hua huamarrësit (shtetasit A. K.) shumën 32.773.000 lekë me një afat kthimi 5-vjecar.

75. Kjo kontratë huaje ndonëse nuk është përmendur më parë nga subjekti i rivlerësimit (pra, një pretendim tjetër i subjektit si burim për huan e dhënë), nuk është sigluar/miratur edhe nga ortaku tjetër i shoqërisë, shtetasi J. A. (vëllai i subjektit), si dhe vlera e pretenduar marrë hua nga shoqëria nuk gjen pasqyrim në evidencat kontabël (pasqyrat financiare) për vitin 2013 të shoqërisë “****” sh.p.k.

76. Bazuar në pasqyrat financiare³² të shoqërisë “****” sh.p.k., aktivet e tjera financiare afatshkurtra për vitet 2013 dhe 2014, konkretisht në zërin “të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, si dhe në aktivet afatshkurtra “të drejta të arkëtueshme të tjera”, në pasqyrat financiare të vitit 2015, janë pasqyruar këto vlera:

Periudha/viti	2013	2014	2015
Gjendje në llogari kontabël në datë 31 dhjetor	9.583.914	24.396.188	223.931
Ndryshim shtesë/pakësim i gjendjeve të llogarisë nga viti paraardhës	0	14.812.274	-24.172.257

77. Sa më sipër, nëse do t’i referohemi përcaktimeve në kontratën e huas “të drejtat dhe detyrimet e ortakëve” në aktivet e tjera financiare afatshkurtra të pasqyrave financiare të vitit 2013³³, do të ishin në vlerë të barabartë ose më të madhe se shuma 32.773.000 lekë, të pretenduara të marrë hua nga ortaku dhe administratori A. K., ndërsa në pasqyrat financiare që japin një evidencë të llogarive në datën 31.12.2013, nuk rezulton kjo vlerë hua e dhënë e pasqyruar.

78. Në datën 31.12.2014, gjendja në këtë zë është pasqyruar me një shtesë në vlerën 14.812.274 lekë në krahasim me vitin paraardhës, këto hua/detyrime të ortakëve janë likuiduar gati plotësisht në vitin 2015, me një detyrim të mbetur nga ortakët në vlerën 223.931 lekë.

³⁰Deklaratën e interesave private të personit të lidhur shtetasit D. K.

³¹Deklaruar dhe kontabilizuar në bilancin e vitit 2014 të shoqërisë “****” sh.p.k., në zërin “të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve”.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020, e DRT-së.

³³Referuar PF 2014, në pasqyrat financiare të vitit 2013 janë pasqyruar në zërin “debitore, kreditorë të tjerë”.

79. Referuar të dhënave të ILDKPKI-së³⁴, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur të vitit 2015, shtetasi A. K. nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë në datën 31.12.2015.

80. Pra, në analizën e bërë nga Komisioni, kjo hua e pretenduar e marrë prej shtetasit A. K. nga shoqëria nuk ndikon, pasi është shlyer plotësisht deri në vitin 2015 (vit në të cilën është dhënë shuma 20.000 euro subjektit të rivlerësimit). Komisioni vlerëson të theksojë se kjo hua nuk është deklaruar as si burim krijimi nga subjekti në deklaratën *Vetting* për shumën e marrë hua, pasi ka deklaruar se si burim i huas së marrë për blerje apartamenti nga shtetasi A. K. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 2.7.2015, kanë qenë të ardhurat e huadhënësit nga paga.

81. Nga Komisioni, ndonëse mbështetur në arsyetimin logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të tij, por aq sa është e përshtatshme/nejoshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, në të ardhura të këtij shtetasi janë përfshirë të gjitha të ardhurat e dokumentuara³⁵.

82. Sa më sipër, mbështetur në një vlerësim të arsyeshëm të të gjitha rrethanave dhe provave, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit A. K., për dhënien e huas në shumën 20.000 euro në vitin 2015.

Hua nga shtetasi K. A.

83. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ndër të tjera, ka deklaruar *hua e marrë për blerje apartamenti nga vëllai K. A., në shumën 10.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 8.9.2015, me burim të deklaruar të ardhurat nga paga.*

84. Në DPV-në e vitit 2015, në formularin mbi detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti ka deklaruar *hua në shumën 10.000 euro, për blerje apartamenti në datën 8.9.2015, nga personi fizik "K. A." me afat 10-vjeçar, pa interes.*

85. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.9.2015, me deklarues shtetasit K. A. dhe Desart Avdulaj, subjekti i njeh detyrimin në formë huaje, pa interes, të shumës 10.000 euro shtetasit K. A. , të cilin do ta shlyejë për një afat 10-vjeçar.

86. Në bazë të të dhënave nga "Raiffeisen Bank" rezulton se në datën 8.9.2015 është depozituar *cash* në llogarinë në euro në emër të subjektit të rivlerësimit shuma 10.000 euro nga shtetasi K. A. , me përshkrimin "dhënie huaje".

87. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: "*Huaja prej 10.000 euro e derdhur nga vëllai im në datën 8.9.2015, ka ardhur nga jashtë shtetit dorazi. E kanë sjellë ai së bashku me bashkëshorten, pasi kanë ardhur të dy atë vit për pushime në Shqipëri ...*".

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020.

³⁵Përfshirë edhe nga dividendë të shpërndarë deri në datën 31.12.2015.

88. Shuma 10.000 euro e dhënë hua në datën 8.9.2015, është kthyer në datën 4.8.2020, me transfertë nga subjekti i rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”.

89. Nga hetimi i Komisionit, rezulton se në vitin 2015 (në të cilën është depozituar *cash* në llogarinë e subjektit shuma 10.000 euro), vëllai i subjektit K. A. ka pasur gjendje në llogaritë bankare brenda vendit në “Raiffeisen Bank”³⁶ dhe “Credins Bank”³⁷ një shumë prej afro 15.000 euro, të cilat kanë mbetur në llogari edhe pas dhënies së huas.

90. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, i ndodhur para një marrëdhënieje të konfirmuar huaje, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, shtetasi K. A. (vëllai i subjektit), kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhënë hua.

91. Për të provuar burimin e deklaruar të të ardhurave të shtetasit K. A., subjekti në dosjen e ILDKPKI-së, ndër të tjera, ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetim lëshuar nga Universiteti Charles në Republikën Çeke, mbi bursat e marra për periudhën 2010 – 2014³⁸; (ii) vërtetim lëshuar nga Instituti i Teorisë dhe Automatizimit, Pragë, datë 26.10.2016, mbi pagat e marra për periudhën 2012 – 2015³⁹; (iii) nxjerrje llogarie bankare e printuar në datën 16.10.2016 nga banka “Komerçni” nga data 17.10.2014 – 13.10.2016, në monedhën CZK (në gjuhën çeke).

92. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur: (i) vërtetim datë 22.7.2019, nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet se *shtetasi K. A. ka qenë punonjës pranë kësaj banke për periudhën 1.7.2005 – 20.2.2006, në momentin e largimit paga bazë mujore ka qenë 43.000 lekë*; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 23.7.2019, nga “Credins Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi K. A. ka qenë punonjës pranë kësaj banke në periudhën 27.2.2006 – 24.8.2006, në pozicionin analist kredie për individë dhe është paguar me pagë bazë mujore *bruto* 65.000 lekë; (iii) vërtetim nr. *** prot., datë 14.8.2020, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë, për të ardhurat e realizuara në “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank”, për periudhën korrik 2005 – gusht 2006.

93. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “të ardhurat nga paga” si burimi i të ardhurave të huadhënësit K. A. për dhënien e huas në shumën 10.000 euro, në vitin 2015.

94. Në bazë të dokumentacionit të dërguar nga subjekti dhe të administruar nga Komisioni, rezulton se: të ardhurat nga paga i përkasin: (i) për periudhën 1.7.2005 – 20.2.2006, nga punësimi në “Raiffeisen Bank”; (ii) për periudhën 27.2.2006 – 24.8.2006, nga punësimi në “Credins Bank”; (iii) për periudhën 2012 – 2015 nga marrëdhëniet e punësimit në Institutin e Teorisë dhe Automatizimit, Pragë.

95. Për sa i përket të ardhurave për periudhën 2005 – 2006, subjekti i ka deklaruar për blerjen

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 15.1.2021.

³⁸Në vitin 2010 shuma 6.050 CZK; në vitin 2011 shuma 77.950 CZK; në vitin 2012 shuma 95.500 CZK; në vitin 2013 shuma 114.100 CZK; në vitin 2014 shuma 17.200 CZK; si dhe grante në vitet 2010 – 2016 shuma 422.238 CZK.

³⁹Në vitin 2012 shuma *neto* 69.700 CZK; në vitin 2013 shuma 85.000 CZK; në vitin 2014 shuma 173.204 CZK; në vitin 2015 shuma 208.387 CZK.

e apartamentit të prindërve në vitin 2009.

96. Me vërtetimin datë 26.10.2016, lëshuar nga Instituti i Teorisë dhe Automatizimit, Pragë, rezultoi se shtetasi K. A. ka përfituar të ardhura *neto* nga paga për periudhën 2012 – 2015, në vlerë 536.291 CZK, ndërsa referuar shpenzimeve dhe konsumit të familjeve të përfshira në anketën e buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke⁴⁰, rezultoi se shpenzimet mesatare për frymë për periudhën 2012 – 2015, llogariten rreth 487.722 CZK. Pra, me një mundësi në dukje për kursim në shumën 48.569 CZK (536.291 CZK - 487.722 CZK) ose e konvertuar në 1.799 euro⁴¹ (pa llogaritur vlerat monetare gjendje në llogari bankare, si dhe pasuri, shpenzime të tjera të krijuara/kryera nga ky shtetas për këtë periudhë).

97. Analiza e mësipërme është bërë deri në fund të vitit 2015, në një kohë që subjekti deklaroi se shuma prej 10.000 euro ka kaluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur *kanë ardhur të dy atë vit për pushime në Shqipëri*, që referuar të dhënave që disponon Komisioni, i përket gushtit të vitit 2015. Pra, nëse analiza financiare do të kryhej deri në gusht të vitit 2015, mundësia e përafërt për kursim individual do të ishte afro 20.005 CZK, konvertuar në afro 741 euro.

98. Në lidhje me bursat e marra për periudhën 2010 – 2014, si dhe grante për periudhën 2010 – 2016, referuar vërtetimit të lëshuar nga Universiteti Charles në Republikën Çeke, Komisioni ka vlerësuar se, megjithëse bursa dhe grantet nuk janë pjesë e burimit të të ardhurave të deklaruara për dhënien e kësaj huaje, aktet e administruara nuk provojnë shpenzimet reale të studimit/jetesës etj., për çdo vit, si dhe pjesën e shpenzimeve të mbuluara nga kjo bursë⁴². Mungojnë marrëveshjet përkatëse të dhënies së bursës/granteve⁴³, si dhe ndarjet e këtyre të fundit sipas viteve.

99. Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit sa duket se, shtetasi K. A. (vëllai i subjektit) nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme huan e dhënë subjektit në vitin 2015⁴⁴.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

100. Në prapësimet e rezultateve të hetimit subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Përveç dokumentacionit të paraqitur deri tani pranë jush kërkohet që të merren si provë edhe disa dokumente të tjerë nga gjuha çeke, kontrata qiraje për periudhën 2012 – 2015 dhe të ardhurat për vitet 2011 – 2015 nga bashkëshortja e personit të lidhur K. A. . Shuma e të*

⁴⁰<https://www.czso.cz/csu/czso/expenditures-and-consumption-of-households-included-in-household-budget-survey-2011-q51s148bwb>

⁴¹Kk.1Eu=27 CZK afërsisht viti 2015 (referuar dokumentit nga Banka Nacionale Çeke, datë 30.8.2020, dorëzuar nga subjekti në pyetësorin nr. 2).

⁴²Referuar jurisprudencës së Kolegjit, vendimi nr. 9, datë 24.10.2018 (parag.81): *“Bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese pa përfshirë luksin. Një ndër arsyet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë qenies në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti... ”.*

⁴³Referuar faqes zyrtare të universitetit, përcaktohet se kandidatët nuk duhet të jenë përfitues të ndonjë burse tjetër të jashtme ose grante për një ndihmë jetese.

⁴⁴Komisioni nuk ka përfshirë në analizën paraprake financiare shumën prej 10.000 euro (në formën e huas nga shtetasi Krenar Avdulaj në vitin 2015 – për të cilën nuk është justifikuar plotësisht burimi i të ardhurave).

gjitha të ardhurave neto nga tetori i vitit 2010 deri në 24 shkurt të vitit 2016 është 733.038 CZK ose 29.000 euro. Shpjegoj duke marrë për bazë faktet e shprehura edhe nga vëllai m K. A. në lidhje me marrëveshjet që përmend Komisioni unë disponoj vetëm kontratat ku kam qenë vetë drejtues granti, për të tjerat nuk kam të drejtë që t'i kem. Për këtë arsye kam marrë vërtetim nga zyra e financës së Universitetit Charles, pasi vërtetimi përmbledh në mënyrë të centralizuar çdo burim të ardhurave dhe një pjesë e granteve janë përdorur për udhëtime dhe konferenca ndërkombëtare, dieta gjatë udhëtimeve, pajisje kompjuterike etj. Të gjitha të ardhurat neto që unë kam përfituar, nga grantet e mia, të kolegëve, shpërblimet për performancë të lartë apo të përfituara nga mësimdhënia janë të përfshira në vërtetimin e lëshuar nga Universiteti Charles ...”.

101. Subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur (vëllai i tij) e shtjelloi, më tej, këtë qëndrim të tij, duke ndërtuar edhe analizën financiare në të cilën ka përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e familjes së tij për periudhën 2008 – 2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

102. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

103. Së pari, disa prej dokumenteve të depozituar pas kalimit të barrës së provës nuk kanë asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, sepse janë vetëdeklarime dhe të tjera dokumente pa vulë apostile, me përkthim të thjeshtë nga gjuha çeke, pa u vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit nga noteri publik. Pra, në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementet formale për vlefshmërinë e tij, të përcaktuara në parashikimet e Konventës së Hagës, datë 5.10.1961, apo parashikimet e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile, i cili kërkon se: *“Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent”.*

104. Në bazë të të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, shuma prej 10.000 euro është depozituar *cash* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 8.9.2015, nga shtetasi K. A.. Në lidhje me prejardhjen e këtyre vlerave monetare, sa më sipër, Komisioni konstaton se me gjithë faktin se personi tjetër i lidhur dispononte vlera monetare në llogari bankare në vend, këto likuiditete deklarohen se kanë ardhur nga jashtë shtetit.

105. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka përfshirë si burim të të ardhurave të personit të lidhur K. A. (vëllai i subjektit) për huan e dhënë në vitin 2015, edhe të ardhurat e bashkëshortes së huadhënësit.

106. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes si burim i ri për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstaton se ky burim nuk është deklaruar më parë nga subjekti dhe/ose shtetasi K. A. (vëllai i subjektit), pra subjekti ka ndryshuar/shtuar burimin e të ardhurave për huan e dhënë nga vëllai i tij pas dërgimit të rezultateve të hetimit, prandaj vlerëson që ky burim i ri të mos merret në konsideratë.

107. Komisioni nuk kishte përfshirë në llogaritjen paraprake të ardhurat nga bursa dhe

grantet, për faktin se nga subjekti nuk ishin dokumentuar të ardhurat e plota për çdo vit, shpenzimet përkatëse që mbulonin bursa, si dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin dhe koha e përfitimit të bursës/grantit nga personi tjetër i lidhur.

108. Në lidhje me të ardhurat e deklaruara në formë burse, përfituar nga Universiteti Charles, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit kanë qenë të karakterit deklarativ, duke mos provuar shpenzimet reale të studimit, jetesës/qëndrimit etj., për periudhën 2010 – 2014, si dhe pjesën e shpenzimeve të mbuluara nga kjo bursë e pretenduar e përfituar deri në vitin 2014.

109. Në lidhje me të ardhurat nga grantet, megjithëse subjekti i rivlerësimit nuk ka përcjellë kontratat e deklaruara të granteve, në vlerësim të deklarimeve të tij, jo e gjithë shumë e pretenduar e përfituar ka qenë për t'u përdorur nga vetë personi tjetër i lidhur, por një pjesë ka qenë për përdorim në udhëtime, konferenca ndërkombëtare, pajisje etj. Pra, si subjekti, ashtu edhe vëllai tij (personi tjetër i lidhur) nuk kanë dokumentuar këto shuma, qëllimin dhe përdorimin e tyre.

110. Për vitin 2013 është paraqitur një vërtetim në të cilin vërtetohet se ka përfituar shumën prej 169.340 CZK (170.000 CZK - 25.500CZK + 24.840CZK), të ardhura të cilat u reflektuan nga Komisioni në analizën për mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur⁴⁵.

111. Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e depozituara, duke mbajtur në konsideratë dhe se shtetasi K. A., përveç huas së sipërcituar në vitin 2015, i ka dhënë subjektit të rivlerësimit: (i) në vitin 2010, hua në shumën 10.000 euro; (ii) në huapërdorje në vitin 2011, automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2005, me targa ***, në pronësi të tij, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm mundësitë financiare të vëllait të tij, shtetasit K. A., nga burime të deklaruara për t'i dhënë hua shumën e pretenduar në vitin 2015.

112. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar edhe një huamarrje tjetër nga shtetasi K. A. e deklaruar si *hua e pakonsumuar (shlyer) në shumën 10.000 euro, marrë në vitin 2010, për qëllime studimi master. Studimet nuk u kryen për arsye objektive.*

113. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit, në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar: *detyrim në shumën 10.000 euro, të marra hua me transfertë bankare nga vëllai që jeton në Çeki me afat 1-vjeçar, për ndjekjen e një masteri në Itali. Masteri nuk u krye, shuma e pashlyer deri në datën 31.12.2010...*

114. Në datën 8.3.2010 në llogarinë në emër të subjektit në “Raiffeisen Bank”, është transferuar shuma 9.904,89 euro, pa përshkrim, nga vëllai K. A.. Ndërsa në datën 29.3.2010 subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 9.901 euro.

115. Sa më sipër, iu kërkua subjektit të rivlerësimit burimi i të ardhurave të shtetasit K. A. (vëllait të tij), për shumën e deklaruar nga subjekti të marrë hua në vitin 2010.

⁴⁵Mundësia për kursim deri në fund të vitit 2015 vetëm e personit tjetër të lidhur me të ardhurat e përfituara nga paga, do të rezultonte 132.909 CZK (620.631CZK - 487.722 CZK) ose e konvertuar në vlerën 4.923 euro (pa llogaritur vlerat monetare gjendje në llogari bankare, si dhe pasuri, shpenzime të tjera të krijuara/kryera nga ky shtetas për këtë periudhë).

116. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁴⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *sa i përket burimit të të ardhurave për shumën e dhënë në datën 8.3.2010, burim janë të ardhurat nga puna e të fejuarës së tij në atë kohë (më vonë bashkëshortja) O. R., si mjeke në departamentin e ORL-së, spitali rajonal ‘***’, ku punon prej korrikut të vitit 2008.*

117. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar bindshëm burimin e të ardhurave të vëllait K. A., pasi aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë huadhënëse të tij, për huan e dhënë.

118. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit⁴⁷, për sa duket se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. K. A., nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme huan e dhënë subjektit në vitin 2010.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

119. Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Shpjegoj duke marrë për bazë faktet e shprehura edhe nga vëllai im K. A. se, për sa i përket huas prej 10.000 euro të dhënë në mars të vitit 2010, kursimet nga paga e bashkëshortes janë plotësisht të mundura, pasi ne kemi bashkëjetuar në një ambient të siguruar nga punëdhënësi i bashkëshortes (spitali rajonal ‘Kolin’) me një pagesë simbolike pre 417 CZK/muaj (ose rreth 16 euro), si dhe shpenzimet e utiliteteve në rreth 1.055 CZK (ose rreth 40 euro). Gjithashtu, punëdhënësit (me mbi 30 punonjës, në mos gaboj) në Republikën Çeke kanë detyrim ligjor të sigurojnë ushqim të subvencionuar (1 euro për vakt në rastin e bashkëshortes sime) për punonjësit e tyre. Për të gjitha këto parashtrime kam sjellë dokumentacion mbështetës dhe shuma është plotësisht e justifikuar”.*

120. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) deklaratën e datës 18.12.2020, të shtetases Oneda Ruci; (ii) vërtetim për të ardhurat e tatueshme nga aktivitetet e varura dhe nga përfitimet funksionale, vlera e tatimit të mbajtur në burim dhe përfitimet tatimore për vitet 2008, 2009 dhe 2010 të shtetases O. R.; (iii) kontratë qiraje (bashkë me shtojcën nr. 1), datë 24.6.2008, kontratë qiraje, datë 30.6.2009 dhe datë 25.11.2009, midis spitalit rajonal “****” dhe shtetases O. R.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

121. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

122. Subjekti i rivlerësimit, si në deklarin periodik të vitit 2010, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të huadhënësit për shumën 10.000 euro, deklaruar dhënë hua në vitin 2010, ndërsa gjatë hetimit ka deklaruar *“... të ardhurat nga*

⁴⁶Depozituar në Komision në datën 19.1.2021.

⁴⁷Komisioni nuk ka përfshirë në analizën paraprake financiare shumën prej 10.000 euro (në formën e huas nga shtetasi K. A. në vitin 2010 – për të cilën nuk është justifikuar plotësisht burimi i të ardhurave).

puna e të fejuarës së tij në atë kohë (më vonë bashkëshortja)..”, si burim për shumën e dhënë në datën 8.3.2010.

123. Në seancën dëgjimore subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: “... në dhënien e huas në vlerën 10.000 euro janë përdorur edhe huaja e dhënë nga e fejuara e tij... nuk ka datë të dhënies së huas... në atë vit e fejuara, bashkëshortja e ardhshme, i ka dhënë 10.000 euro...”.

124. Sa më sipër, Komisioni vëren se deklaratimet e subjektit nuk mbështeten në dokumentacionin e disponuar, në deklaratimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se *burim janë të ardhurat nga puna e të fejuarës së tij në atë kohë (më vonë bashkëshortja)*. Ndërsa në seancë dëgjimore deklaroi se *përveç të ardhurave të vëllait, janë përdorur edhe huaja e dhënë nga e fejuara e tij*.

125. Referuar dokumentacionit të dërguar nga subjekti për të ardhurat e personi tjetër të lidhur, shtetasit K. A. (vëllai i subjektit), Komisioni konstaton se ky shtetas ka konkurruar dhe ka fituar konkursin në programin e doktoraturës në gjuhën çeke në datën 1.7.2010, duke vlerësuar se edhe nëse janë përfituar të ardhura pas datës 1.7.2010, ato nuk mund të kenë shërbyer për dhënien e huas më 8.3.2010.

126. Në bazë të kontratave të qirasë të depozituara, rezulton se shtetasja O. R. ka marrë me qira nga spitali rajonal “***” një dhomë banimi⁴⁸ me një shtrat, për përdorim të hapësirës së rezervuar të akomodimit dhe dhomës (sende të luajtshme) për periudhat 24.6.2008 – 30.6.2009; 30.6.2009 – 31.12.2009 dhe 1.1.2010 – 6.7.2010. Në bazë të shtojcës nr. 1 totali i pagesave të qirasë (përfshi edhe kostot e energjisë elektrike) rezulton në vlerën 1.472 CZK/muaj dhe për periudhën qershor 2008 – shkurt 2010 në vlerën 29.440 CZK ose 1.090 euro.

127. Referuar të dhënave mbi shpenzimet mesatare vjetore për frymë në Çeki për vitet 2008, 2009 dhe 2010⁴⁹, rezulton se për vëllain e subjektit të rivlerësimit dhe të fejuarën këto shpenzime për periudhën qershor 2008 – shkurt 2010, janë në vlerën 352.242 CZK⁵⁰, konvertuar në 13.046 euro, ndërsa të ardhurat *neto* nga punësimi në spitalin rajonal “Kolin” Pragë, deri në shkurt të vitit 2010, të shtetasit O. R. llogariten në afro 534.009 CZK⁵¹, me një mundësi të përafërt për kursim në shumën 181.767 CZK (534.009CZK-352.242CZK), ose 6.732 euro.

128. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, shtetasit K. A. (vëllai i subjektit), për dhënien e huas në shumën 10.000 euro në mars të vitit 2010 dhe për t’i dhënë hua shumën e pretenduar në vitin 2015.

Hua nga shtetasi Gj. A.

⁴⁸Në një godinë pranë spitalit rajonal Kolin, e cila është menduar për akomodim të përkohshëm të punonjësve të spitalit.

⁴⁹Të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në shpjegime të rezultateve të hetimit (viti 2008 në vlerën 112.256 CZK; viti 2009 në vlerën 115.309 CZK; dhe viti 2010 në vlerën 116.427 CZK).

⁵⁰[(56.128 CZK+115.309CZK+19.404CZK) *2-29.440CZK].

⁵¹Referuar vërtetimeve për të ardhurat e tatueshme nga aktivitetet e varura dhe nga përfitimet funksionale për vitin 2008 të ardhurat *neto* llogariten në 140.340 CZK; për vitin 2009 në vlerë 329.877 CZK dhe për periudhën deri janar – shkurt 2010 në vlerë rreth 63.792 CZK (382.753CZK/12*2).

129. Me deklaratën noteriale për njohje detyrimi nr. ***, datë 26.10.2015, me deklarues shtetasit Gj. A. dhe Desart Avdulaj, subjekti i njeh një detyrimin në shumën 15.000 GBP shtetasit Gj. A., për një afat 10-vjeçar, pa interes, në formë huaje, e cila është lëvruar në llogarinë e subjektit në “Raiffeisen Bank” në datën 18.5.2015.

130. Në DPV-në e vitit 2015, në formularin mbi detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti deklaron: *“Hua e marrë në shumën 15.000 GBP për blerje apartamenti në datën 26.10.2015, nga personi fizik ‘Gj. A.’. Hua me afat 10-vjeçar, pa interes”*.

131. Në formularët mbi detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, si dhe të dhëna konfidenciale, pjesë e deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Hua e marrë në datën 18.5.2015, nga kushëriri Gj. A, në shumën 15.000 GBP, pa interes, me afat 10-vjeçar, me burim të ardhurat nga paga”*.

132. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentet: (i) nxjerrje e llogarisë bankare të shtetasit Desart Avdulaj në “Raiffeisen Bank” në monedhën GBP; (ii) certifikatë fundviti P60, për të ardhurat dhe pagesës së tatimeve deri në datën 5.4.2015, si dhe deri më 5.4.2016 në Angli, për shtetasin Gj. A.;(iii) nxjerrje llogarie bankare “NatWest” të shtetasit Gj. A., me banim në Londër, për periudhën 11.4.2015 – 10.7.2015.

133. Nga hetimi i Komisionit, rezulton se shuma prej 15.000 GBP ka mbërritur me transfertë në llogarinë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” në datën 14.5.2015. Kjo shumë është tërhequr në dy këste nga shtetasi J. A. , në datën 23.6.2015, shumën 6.000 GBP dhe në datën 10.12.2015 shumën 9.000 GBP. Në datën 18.5.2017, i është kthyer me transfertë shuma 15.027,45 GBP shtetasit Gj. A., me përshkrimin “pagesë huaje datë 18.5.2015” .

134. Referuar të dhënave të dërguara në përgjigje të pyetësorëve, shtetasi Gj. A., për vitin 2015 ka realizuar të ardhura në vlerë 41.856 GBP (tatim 6.369 GBP) dhe për vitin 2016 shuma e të ardhurave referuar dokumentacionit të dorëzuar është 43.448 GBP (me një tatim në vlerë 6.778 GBP), gjithashtu, nga informacioni bankar i dërguar rezulton se në datën 11.4.2015 gjendja në llogarinë në “NatWest” është në shumën 23.355,57 GBP, ndërsa në datën 14.5.2015 është transferuar shuma prej 15.034,5 GBP.

135. Aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, shtetasi G. A., në vitin 2015, pasi mungon informacioni për të ardhurat e vitit 2014, si dhe lëvizje/gjendje në llogarinë bankare të huadhënësit përpara datës 11.4.2015 (pasi llogaria e depozituar vjen me një gjendje të mbartur në shumën 23.355,57 GBP, në datën 11.4.2015) dhe deri në datën 31.12.2015. Gjithashtu, në datën 10.6.2015, ka kreditim në llogari shumën 3.000 GBP, për të cilën nuk janë të qarta forma dhe urdhëruesi. Mungon informacioni për numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera për jetesë apo dhe të tjera në periudhën 2014 – 2015, nëse kanë investuar në pasuri, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së tyre për të dhënë këtë hua.

136. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa më sipër duket se shtetasi Gj. A., nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme huan e dhënë subjektit në vitin 2015.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

137. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Shuma e të ardhurave të kursyera nga Gj. A. deri në momentin që më ka dhënë huan në shumën 15.000 GBP në vitin 2015 ka qenë 122.925 GBP”*.

138. Subjekti, ndër të tjera, ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) deklaratën ligjore, datë 5.5.2021, të shtetasit Gj. A.; si dhe (ii) formularët P60, certifikatë e fundit të viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

139. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se subjekti ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave, si dhe mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit Gj. A., për dhënien e huas në shumën 15.000 GBP në vitin 2015.

Analiza e burimit të krijimit kursime ruajtur në banesë gjatë viteve në shumën 31.880 euro

140. Në lidhje me këtë burim të deklaruar, nga Komisioni u shqyrtuan deklaratimet e subjektit në ILDKPKI, për periudhën 2003 – 2015⁵², si dhe deklarata *Vetting* duke analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) për krijimin e kursimeve *cash* në banesë të deklaruara.

141. Në deklaratën *Vetting*, në deklaratën e pasurisë të personit të lidhur (bashkëshortja e subjektit), ndër të tjera, ka deklaruar: *“Dhuratë nga familjarët e mi me rastin e martesës në vitin 2009 në shumën 500.000 lekë; kursime personale nga puna para martesës së vitit 2009 në shumën 500.000 lekë”*.

142. Në DPV-në e vitit 2009, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, ka deklaruar: *“Dhuratë monetare me rastin e martesës nga familja dhe të afërmit (të ruajtura në shtëpi), shuma 500.000 lekë; kursime nga puna si specialiste auditi në Këshillin e Qarkut Gjirokastër (të ruajtura në shtëpi), shuma 500.000 lekë pjesa në përqindje 100%”*.

143. Mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye analizë financiare: (i) për të evidentuar mundësinë financiare të personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) për të kursyer shumën 500.000 lekë deri në datën 30.4.2009, nga burimet e deklaruara, si dhe kryerjen e shpenzimeve të

⁵²(i) në deklarimin për herë të parë në datën 31.3.2004 nuk deklaroi kursime gjendje *cash*; (ii) në DPV-në e vitit 2004 nuk deklaroi kursime *cash*; (iii) në DPV-në e vitit 2005 nuk deklaroi kursime *cash*; (iv) në DPV-në e vitit 2006 deklaroi gjendje *cash* në banesë në shumën 150.000 lekë; (v) në DPV-në e vitit 2007 deklaroi kursime *cash* në banesë në shumën 200.000 lekë; (vi) në DPV-në e vitit 2008 deklaroi kursime të mbajtura në banesë në shumën 300.000 lekë nga të ardhurat e vitit 2008; (vii) në DPV-në e vitit 2009 deklaroi kursime (të ruajtura në banesë) në shumën 500.000 lekë, ndërsa bashkëshortja, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, deklaroi dhuratë monetare me rastin e martesës nga familja dhe të afërmit (të ruajtura në banesë) në shumën 500.000 lekë, kursime nga puna si specialiste auditi në Këshillin e Qarkut Gjirokastër (të ruajtura në banesë) në shumën 500.000 lekë, pjesa në përqindje 100%; (viii) në DPV-në e vitit 2010 deklaroi kursime (të ruajtura në banesë) në shumën 500.000 lekë; (ix) në DPV-në e vitit 2011 deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumën 450.000 lekë; (x) në DPV-në e vitit 2012 deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumën 800.000 lekë; (xi) në DPV-në e vitit 2013 deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumën 1.000.000 lekë; (xii) në DPV-në e vitit 2014 deklaroi kursime të ruajtura në banesë për vitin 2014 në shumën 1.200.000 lekë; si dhe (xiii) në DPV-në e vitit 2015 deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumën 1.250.000 lekë nga të ardhurat nga pagat.

evidentuara dhe deklaruar për këtë periudhë; (ii) për mundësinë financiare të gjithë familjes së bashkëshortes⁵³, për kursimin e shumës 500.000 lekë (deklaruar gjendje *cash* nga bashkëshortja e subjektit në datën 30.4.2009), si dhe shumës prej 500.000 lekësh të deklaruar dhuruar vajzës së tyre (bashkëshortes së subjektit me rastin e martesës në datën 30.4.2009), duke përfshirë të ardhurat e dokumentuara të familjes, shpenzimet jetike sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së dhe të tjera të evidentuara, si dhe gjendjen në llogarinë depozitë të babait të bashkëshortes në datën 30.4.2009.

144. Në analizat financiare si bashkëshortja, ashtu edhe pjesëtarët e familjes, duket se nuk kanë arritur të justifikojnë me burime të ligjshme të ardhurash shumë të deklaruar të kursyer në vlerën 500.000 lekë, si dhe shumë të dhuruar nga prindërit me rastin e martesës në vlerën 500.000 lekë në datën 30.4.2009.

145. Gjithashtu, nga analiza paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, për sa i përket kursimeve të deklaruar si gjendje *cash* në vitet 2008, 2011⁵⁴, 2012 dhe 2013, rezultojnë me balancë negative fondesh (përkatësisht -218.137 lekë ; -1.326.811 lekë⁵⁵; -361.463 lekë dhe -431.401 lekë), konkretisht:

Analiza paraprake e treguesve financiarë				
Vitet	2008	2011	2012	2013
Përshkrimi	Vlera/lekë	Vlera/lekë	Vlera/lekë	Vlera/lekë
Të ardhurat subjekti i rivlerësimit nga marrëdhëniet e punësimit	960.338	922.041	952.661	1.007.003
Të ardhura shpërblime dhe honorarë, subjekti	0	46.773	28.064	9.616
Të ardhurat e bashkëshortes nga marrëdhëniet e punësimit	0	488.871	594.631	825.868
Të ardhura shpërblime dhe honorare bashkëshortja ("Raiffeisen Bank")	0	81.000	0	0
Total të ardhura/të hyra financiare	960.338	1.538.685	1.575.356	1.842.487
Shpenzime shkollimi dhe eksperiencë profesionale	75.000	277.860	279.180	419.680
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	226.306	21.812	350.929	27.339
Shpenzime për sigurime/ regjistrim automjeti etj.	0	21.400	1.396	0
Shpenzime transport i brendshëm (Tiranë-Durrës dhe kthim)	0	0	0	26.803
Shpenzime për pagesë avokatie dhe noteriale	0	0	0	112.000
Shpenzime për qira deklaruar	0	50.000	50.000	50.000
Shpenzime në formë ndihme për prindërit deklaruar pyet. nr. 3	240.000	0	0	0
Shpenzim /transferim në llog. të vëllait K. Avdulaj në vitin 2011	0	1.379.600	0	0
Pagesë interesa <i>overdrafti</i> "ProCredit Bank" bashkëshortja	0	0	2.792	16.928
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së	136.620	273.240	279.096	282.048

⁵³Pasi në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se *bashkëshortja ka kontribuar nga të ardhurat e pagës për familjarët e saj për periudhën para martesë.*

⁵⁴Nga Komisioni janë vlerësuar të pasqyrohen paraprakisht në shpenzime edhe shumat e transferuara pa përshkrim nga subjekti i rivlerësimit në llogari të vëllait K. A., në vlerë totale 10.000 euro në vitin 2011, në dy këste, si dhe në dy banka të ndryshme (pasqyruar në aneks të rezultateve të hetimit).

⁵⁵Analizuar edhe më poshtë te pasuritë e krijuara në vitin 2011.

Total shpenzime/ të dala financiare	677.926	2.023.912	963.393	934.798
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gj. fillim-gj. fund periudhe	-300.000	-450.000	-800.000	-1.000.000
Ndryshim mjete monetare gj. fillim-gj. fund periudhë dokumentuar	-200.549	142.416	-96.426	-205.090
Mjete monetare të disponueshme (1)	-218.137	-792.811	-284.463	-297.401
Autoveturë “Renault Clio”, viti 2000 (blerë me faturë datë 23.4.2011)	0	420.000	0	0
Pasuri të tjera (armë gjahu blerë në datën 8.3.2011)	0	114.000	0	0
Huadhënie/të tjera	0	0	77.000	134.000
Total pasuri (2)	0	534.000	77.000	134.000
Balanca e fondeve (1-2)	-218.137	-1.326.811	-361.463	-431.401

146. Sa më sipër, për shumën 2.337.812 lekë (218.137 lekë + 1.326.811 lekë + 361.463 lekë + 431.401 lekë), duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për kursimin e tyre. Komisioni ka vlerësuar që kjo shumë të zbritet nga shuma *cash* e deklaruar deri në datën 31.12.2014, përdorur si burim për pagesë kësti apartamenti në Tiranë.

147. Pas analizës paraprake të treguesve financiarë, nga Komisioni u analizuan kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti, të mbajtura në banesë për periudhën 2003 – 2014, gjendjet e llogaritura sipas DPV-ve, pyetësorit, si dhe mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes, ndër vite, për krijimin e pasurive, duke u pasqyruar në tabelën në vijim:

Viti	Deklarim në DPV	Gjendje në banesë më 31 dhjetor			Përshkrim/analizë
		Ref. DPV	Pas përgj. pyetësorit nr. 3	Llog. Komisioni dërguar me rezultatet e hetimit	
2003	0	0	0	0	
2004	0	0	0	0	
2005	0	0	0	0	
2006	150.000	150.000	150.000	150.000	
2007	200.000	350.000	200.000	200.000	
2008	300.000	650.000	500.000	281.863	(-218,137 lekë të pajustificuar)
2009	1.500.000	2.150.000	2.000.000	781.863	(-1,000,000 lekë të pajustificuar)
2010	500.000	2.650.000	2.500.000	1.281.863	
2011	450.000	3.100.000	2.950.000	405.052	(-1,326,811 lekë të pajustificuar)
2012	800.000	3.900.000	3.750.000	843.589	(-361,463 lekë të pajustificuar)
2013	1.000.000	4.900.000	4.750.000	1.412.188	(-431,401 lekë të pajustificuar)
2014	1.200.000	6.100.000	5.950.000	2.612.188	

148. Në vlerësim dhe analizë të dokumentacionit të disponuar, deklarimeve të subjektit, si dhe mundësisë financiare për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara, duket se shuma e likuiditeteve të llogaritura si gjendje *cash* në banesë në datën 31.12.2014, rezulton në vlerën 2.612.188 lekë [6.100.000 lekë-(150.000 lekë +1.000.000 lekë+ 2.337.812 lekë)].

149. Sa më sipër, likuiditetet *cash* në banesë, të llogaritura si të mundshme për t'u kursyer, duket se janë në vlerën 2.612.188 lekë, të pamjaftueshme për pagesën e shumës 31.880 euro, ose 4.376.486 lekë⁵⁶, të deklaruar (nga kursimet e ruajtura në banesë gjatë viteve) si burim për pagesën e një pjesë të çmimit për blerjen e apartamentit në *** në vitin 2015.

150. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të justifikojë me të ardhura nga burime financiare të ligjshme kursimet *cash* në banesë të deklaruara si burim për pagesën e kryer për pasurinë apartament banimi me sip. 169.8 m², në ***, Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

151. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dërguara pas rezultateve të hetimit në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës 500.000 lekë, të deklaruara si dhuratë nga familjarët e bashkëshortes me rastin e martesës në vitin 2009, i ka ndarë në: (i) shuma 375.000 lekë, nga vlerësimi i deklaratave noteriale të familjarëve dhe shoqërisë së bashkëshortes⁵⁷, të cilat kanë shkuar për vizitë në banesën e saj në fshatin A. Z. dhe me rastin e martesës së saj kanë hedhur sasi të ndryshme monetare; (ii) pjesa tjetër prej 125.000 lekësh është plotësuar pjesërisht nga të ardhurat nga paga të nënës së bashkëshortes; dhe (iii) pjesërisht nga fitimet nga shitja e prodhimeve bujqësore.

152. Subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“... familjarët e bashkëshortes sime përveç të ardhurave nga pagat kanë ushtruar edhe aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Me vërtetimin nr. *** prot., datë 4.5.2021, të Bashkisë Gjirokastrë, i cili kërkoj që të merret nga ju si provë, vërtetohet se z. E. Q. ka përfutur tokë bujqësore nga ligji nr. 7501/1991 dhe ka paguar rregullisht taksat mbi tokën bujqësore dhe se ka shfrytëzuar tokën duke ushtruar aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Prindërit e bashkëshortes sime deklarojnë se kanë kultivuar tokat e tyre bujqësore me prodhime bujqësore dhe mjekësore duke arritur të nxjerrin shpenzimet e jetesës dhe të kursejnë gjithashtu nga 200-300 mijë lekë në vit sipas rastit.*

Në mbështetje të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ jam në pamundësi objektive për të provuar sasinë e prodhimeve bujqësore dhe medicinale, si dhe personat që e kanë blerë atë pasi në mungesë të shkresave të thjeshta apo mandatpagesave nuk kam rrugë tjetër si t’i marr, për shkak se prodhimet dhe shitjet e produkteve bujqësore kanë ndodhur para vitit 2009 dhe tek persona të ndryshëm qoftë në zonën e Gjirokastrës qoftë nga rrethet e tjera...”.

153. Ndërsa në lidhje me shumën 500.000 lekë, të deklaruara kursime nga puna si specialiste auditi në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë (të ruajtura në banesë) nga bashkëshortja e tij,

⁵⁶Konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë, datë 31.12.2015 (faqe online).

⁵⁷Deklaratat noteriale nr. ***, datë 6.5.2021; nr. ***, datë 7.5.2021; nr. ***, datë 6.5.2021.

subjekti në shpjegimet pas rezultateve, ndër të tjera, ka kërkuar: “...të merren në konsideratë se prindërit e bashkëshortes kanë kryer aktivitet si të vetëpunësuar në bujqësi (fermerë) dhe kanë realizuar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore; të merren në konsideratë se për periudhën 1.1.2008 – 30.4.2009, prindërit e bashkëshortes ia kanë lënë pagën që ta kursejë dhe shpenzimet për jetesë janë përballuar nga ana e tyre...”.

154. Në lidhje me analizën e treguesve financiarë, si dhe mundësinë financiare për të kursyer shumat *cash* të deklaruara si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, deklaroi se: “Në DPV-në e vitit 2010 kam deklaruar ‘detyrim në shumën 10.000 euro të marra hua ...për ndjekjen e një masteri në Itali. Masteri nuk u krye për arsye objektive’. Në DPV-në e vitit 2011 kam deklaruar ‘detyrim për studime në shumën 10.000 euro ndaj vëllait tim K. A. ... mars 2010 - maj 2011, afat kthimi 1-vjeçar për studime masteri... Studimet nuk u zhvilluan. Shuma 10.000 euro u shlye e gjitha. Ky detyrim i papërdorur nga ana ime ju transferua përsëri nga ana ime K. A. në llogarinë e tij...’. Nga sa kam deklaruar është e qartë që unë shumën e marrë nga vëllai nuk e kam përdorur dhe ia kam kthyer atij siç e kam marrë. Burimi për kthimin e shumës është vete shuma e marrë prej tij dhe kjo kuptohet nga deklarimi im. Kam menduar që deklarimi që kam bere ka qenë i mjaftueshëm pa specifikuar që këtë shumë pas tërheqjes nga banka e kam mbajtur *cash*. Në vitin 2013 Komisioni nuk ka llogaritur të ardhurat nga paga e bashkëshortes pranë Qendrës Komunitare Gjirokastër në shumën 173.250 lekë; në vitin 2013 unë kam përfutuar nga InterAlbanian shumën 41.000 lekë për dem Kasko”.

155. Në seancë dëgjimore subjekti ka depozituar duke kërkuar të merren në cilësinë e provës edhe dokumente që lidhen me konstatimet e Komisionit për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve dhe qëndrimeve jashtë vendit për vitin 2008.

156. Gjithashtu, subjekti ka kryer edhe një analizë financiare në formë tabelore, për vitet 2008, 2011, 2012 dhe 2013.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

157. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet e provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

158. Lidhur me pasqyrimin e gjendjeve *cash* në banesë, Komisioni është referuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DPV-të përkatëse, duke vlerësuar edhe jurisprudencën e Kolegjit⁵⁸, përcaktimeve në legjislacionin përkatës⁵⁹, dokumentacionit ligjor justifikues të burimit të deklaruar, mundësinë financiare për krijimin e tyre dhe destinacionin e tyre.

i. Në lidhje me shumën prej 500.000 lekësh të deklaruar si dhuratë nga familjarët e bashkëshortes me rastin e martesës në vitin 200, në shpjegimet pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ka ndryshuar/shtuar burimet e deklaruara të të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes për dhuratën në shumën 500.000 lekë, konkretisht janë shtuar

⁵⁸Referuar jurisprudencës së Kolegjit (vendim nr. 29/2019, nr. 11/2019).

⁵⁹Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

dhurimet e familjarëve dhe shoqërisë së bashkëshortes të cilat kanë shkuar për vizitë në banesën e saj me rastin e martesës, si dhe fitimet nga shitja e prodhimeve bujqësore.

159. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi i tij gjatë hetimit administrativ në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë burim krijimi, i krijuan bindjen trupit gjykues se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë burim krijimi janë përpjekje të tij për të justifikuar mungesën e burimit të të ardhurave të familjarëve të bashkëshortes për shumën e deklaruar të dhuruar në vitin 2009.

160. Ndërsa në lidhje me shpenzimet minimale për konsum, Komisioni vlerëson se, ndonëse familjarët e bashkëshortes së subjektit kanë jetuar në fshat, të dhënat referuese nga INSTAT-i përfaqësojnë shpenzime minimale jetike në vlera të mesatarizuara, për më tepër që të ardhurat e dokumentuara të tyre për periudhën 2000 – prill 2009 janë në vlerën 696.156 lekë, ndërkohë që kjo vlerë, referuar të dhënave nga INSTAT-i, ka qenë e pamjaftueshme për shpenzime minimale për konsum për një person për këtë periudhë dhe jo për një familje prej 5 personash, pa përfshirë dhuratën në shumën 500.000 lekë dhe depozitën bankare në emër të babait të bashkëshortes.

161. Pasja e tokës bujqësore dhe derdhja e kontributeve vullnetare për pension, në vlerësim të trupit gjykues, nuk janë faktorë që mund të provojnë një aktivitet bujqësor tregtar, fitimprurës dhe shumën e të ardhurave të realizuara. Nuk ka të shprehur në ndonjë akt ligjor të periudhës që të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore janë të patatueshme.

162. Në bazë të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999⁶⁰, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, pika 1, i ndryshuar, ka qenë e përcaktuar se: “...çdo person e fiton të drejtën të ushtrijë veprimtari ekonomike vetëm pasi të regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi ai detyrohet të kërkojë pajisjen me certifikatë tatimore. Kjo kërkesë paraqitet në degën e tatimeve të rrethit, ku personi ka selinë e veprimtarisë së tij...”.

163. Trupi gjykues, përkundër pretendimit të subjektit se ka vend të zbatohet neni 32, pika 2, për dokumentacion të munguar vëren se asnjë nga shkresat, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit, mungesën e dokumentacionit nuk ia atribuon kohës apo shkaqeve të tjera. Për sa deklarohe dhe provohet që babai i bashkëshortes ka ushtruar një aktivitet tregtar fitimprurës të paregjistruar në organin tatimor, nuk mund të pretendohet për pamundësi objektive për të provuar të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet.

164. Sa më sipër, Komisioni bazuar në provat e administruara, ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit⁶¹, arsyeton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijim të pasurisë. Trupi gjykues vlerëson se subjekti, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur (familjarët e bashkëshortes), nuk kanë arritur të provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave për shumën 500.000 lekë, të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën e interesave private

⁶⁰I cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

⁶¹Vendim nr. 32, datë 21.11.2019.

të personit të lidhur si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në DPV-në e vitit 2009, si dhuratë monetare nga familjarët e saj me rastin e martesës në vitin 2009, e cila është përdorur si burim për blerje të pasurisë së paluajtshme apartament në Tiranë në vitin 2015.

ii. Në lidhje me shumën prej 500.000 lekësh, deklaruar të kursyer nga bashkëshortja e kursyer nga puna si specialiste auditi në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, në shpjegimet pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar burimet e deklaruara të të ardhurave të bashkëshortes për të kursyer shumën 500.000 lekë, konkretisht janë shtuar të ardhura të prindërve të bashkëshortes nga shitja e produkteve bujqësore dhe mjekësore, si të vetëpunësuar në bujqësi (fermerë) dhe kanë realizuar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore (duke bashkëlidhur edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.5.2021).

165. Deklarimet e kryera pas kalimit të barrës së provës dhe pa asnjë provë apo gjurmë të lënë më parë, çmohen nga trupi gjykues se nuk mund të pranohen, pasi krijojnë dyshime se ato mund të bëhen me qëllim justifikimin e mungesave në burimet financiare të subjektit dhe/ose personit të lidhur për krijimin e vlerave monetare në *cash*.

166. Trupi gjykues, përkundër pretendimit të subjektit se ka vend të zbatohet neni 32, pika 2, për dokumentacion të munguar vëren se asnjë nga shkresat, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit, mungesën e dokumentacionit nuk ia atribuon kohës apo shkaqeve të tjera. Për sa deklarohej dhe provohet që babai i bashkëshortes ka ushtruar një aktivitet tregtar fitimprurës të pajisur në organin tatimor, nuk mund të pretendohet për pamundësi objektive për të provuar të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet.

167. Mbështetur në sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëshortes për kursimin e shumës 500.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e interesave private të personit të lidhur në DPV-në e vitit 2009, si edhe në deklaratën *Vetting*, e cila është përdorur si burim për blerje të pasurisë së paluajtshme apartament në Tiranë në vitin 2015, për sa kohë subjekti nuk provoi as kërkesat specifike që kërkon dispozita ligjore neni 32 pika 2.

168. Në lidhje me gjendjet *cash* të deklaruara dhe pa mundësitë për kursim të subjektit dhe personit të lidhur të konstatuara nga Komisioni për vitet 2008, 2011⁶², 2012 dhe 2013⁶³ në vlerësim të dokumentacionit të disponuar dhe deklarimeve të subjektit pas prapësimeve/seancës dëgjimore dhe rishikimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit jashtë vendit për vitin 2008, trupi gjykues arrin në konkluzion se likuiditetet *cash* në banesë, të llogaritura si të mundshme për t'u kursyer, rezultojnë në vlerën 2.641.157 lekë, duke qenë të pamjaftueshme për pagesën e shumës 31.880 euro, të deklaruar (nga kursimet e ruajtura në banesë gjatë viteve), si pjesë e çmimit të paguar për blerjen e pasurisë apartament me sip. 169,8 m² në Rrugën ***, Tiranë .

169. Në përfundim të analizës së burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin/blerjen e pasurisë të llojit apartament me sipërfaqe 169,8 m², në Rrugën e

⁶²Pasqyruar/analizuar edhe më poshtë në analizën e pasurive të krijuara në këto vite.

⁶³Për të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes nga Qendra Komunitare Gjirokastrë nuk u vërtetua/dokumentua pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore: Ndërsa për sa i përket dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimeve, Komisioni vlerëson se jepet me qëllim rregullimin e dëmeve të shkaktuara tek automjeti nga të tretë, pra për të kryer një shpenzim për rregullimin e dëmit.

Kavajës, Tiranë, Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes), për blerjen e kësaj pasurie, kursimet e deklaruara *cash* për këtë vit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë periudhë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit sa duket se: subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për pasurinë apartament banimi me sip.169.8 m², në Rrugën e Kavajës, Tiranë, kursimet e deklaruara *cash* në banesë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2015, duke rezultuar me një balancë paraprake negative në vlerën 13.087.476 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

170. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në kundërshtim me sa konstaton Komisioni, unë kam pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit. Siç është argumentuar më lart, të gjithë huadhënësit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shumat që më kanë dhënë hua. Gjithashtu, unë kam pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer gjatë viteve shumën 31.880 euro, të përdorur për blerjen e apartamentit”*.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë pasuri

171. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, deklaratimet e kryera dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, si dhe analizën e burimeve financiare të krijimit të deklaruara nga subjekti, pasqyruar më sipër, për pasurinë apartament banimi me sip. 169.8 m² në “****”, Tiranë, arrin në përfundimin se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave për huat e dhëna nga huadhënësit, që kanë shërbyer për blerjen e tij:

i) vëllai J. A. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 21.4.2015 (3.4.2015⁶⁴), me burim të ardhurat nga paga;

ii) shtetasi A. K. në shumën 20.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 2.7.2015, me burim të ardhurat nga paga;

iii) vëllai K. A. në shumën 10.000 euro, pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 8.9.2015, me burim të ardhurat nga paga.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ligjshmërinë e likuiditetet *cash* në banesë, prej 31.880 euro, pasi nga hetimi administrativ u provua vetëm vlera prej 2.641.157 lekësh e mundshme për t’u kursyer deri në datën 31.12.2014.

172. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi me sip. 169,8 m² në “****”, Tiranë, në shumën 101.880 euro, në kuptim të parashikimeve të nenit D,

⁶⁴Deklaruar në të dhëna konfidenciale deklarata *Vetting*.

pikave 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjeti tip “Mercedes-Benz”

173. Me kontratë huapërdorje automjeti, datë 17.10.2011, shtetasi K. A. , përfaqësuar nga vëllai J. A. , në cilësinë e huadhënësit, i ka dhënë në huapërdorje automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, subjektit të rivlerësimit, me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë vendit për një periudhë të përcaktuar deri në 1 vit.

174. Referuar të dhënave nga DPSHTRR-ja⁶⁵, rezulton se shtetasi K. A., i përfaqësuar nga z. J. A., ka blerë me kontratë shitjeje të datës 28.9.2010, në çmimin 17.000 euro automjetin tip “Daimler AG MB 163”, me vit prodhimi 2005, ngjyrë gri, me naftë.

175. Automjeti është regjistruar në datën 13.10.2010, me targa *** dhe në datën 10.10.2011 është ndryshuar në ***.

176. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e pagës së subjektit në datën 16.8.2011 është kredituar shuma prej 166.100 lekësh nga shoqëria “****”, me përshkrimin “dëmi Desart Avdulaj, kasko ***”.

177. Sa më sipër, duket se automjeti ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit edhe përpara datës së lidhjes së kontratës së huapërdorjes.

178. Gjithashtu, referuar të dhënave nga AMF-ja⁶⁶, rezulton se në policat e sigurimit (nr. ***, datë 20.10.2015; nr. ***, datë 20.10.2016; nr. ***, datë 19.10.2017, të shoqërisë “****”), si përdorues vazhdon të pasqyrohet subjekti i rivlerësimit, i cili ka një marrëdhënie përdorimi të dokumentuar prej rreth 7 vjet të kësaj pasurie të luajtshme.

179. Komisioni vlerëson se kjo marrëdhënie përfshihet te marrëdhëniet e huas që parashikon pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, marrëdhënie e cila karakterizon vëllanë e subjektit të rivlerësimit edhe në këtë rast si person tjetër të lidhur për këtë pasuri dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

180. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar⁶⁷ se: “... automjeti me targa *** është blerë nga vëllai im në datën 28.9.2010, në shumën 17.000 euro. Sa i përket burimit të të ardhurave të blerjes së automjetit vëllai i ka marrë hua nga shtetasi Gj. A.. Ky i fundit e ka burimin e të ardhurave nga puna. Bashkëngjitur po ju dërgoj deklaratën noteriale të lëshuar nga z. Gj. A. dhe kopje të të ardhurave nga puna sipas formularëve P60 për periudhën prill 2008 – prill 2010”.

181. Me deklaratën e datës 4.11.2020, shtetasi Gj. A. deklaron se: “... në vitin 2009 dhe 2010 i dhashë hua një shumë totale prej 15.000 GBP (stërlina) pa interes, K. A. t... Kjo hua më është paguar plotësisht”.

182. Sa më sipër, Komisioni nuk gjen bindëse argumentet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit për burimin e të ardhurave të vëllait K. A., rezident në Çeki, për blerjen e

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2020.

⁶⁶Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2020.

⁶⁷Në përgjigje shtesë të pyetësorit nr. 3 dërguar në Komision në datën 19.1.2021.

automjetit tip “Daimler AG MB 163”, në shumën 17.000 euro, në datën 28.9.2010, i cili ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

183. Gjithashtu, trupi gjykues ka referuar se:

i) subjekti e ka përdorur këtë automjet për një kohë të gjatë, pa kundërshtim dhe pa ndërprerje;

ii) subjekti nuk e ka deklaruar në asnjë nga deklaratimet periodike vjetore këtë huapërdorje në afat të gjatë të këtij automjeti;

iii) kjo pasuri në huapërdorje është blerë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, i cili nuk provon me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme;

iv) për më tepër, gjatë hetimit administrativ kur subjekti u pyet nga Komisioni lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se vëllai mori hua të afërmit në Angli për blerjen e këtij automjeti.

184. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se vëllai i tij K. A. nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “Daimler AG MB 163”, për çmimin 17.000 euro, në datën 28.9.2010, i cili ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dyshimet se është përpjekur të fshehtë këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

185. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në lidhje me këtë çështje shpjegoj se nuk kam mohuar se kam përdorur automjetin e vëllait tim që nga viti 2011. Më tepër që këtë përdorim e kam përmendur dhe në deklaratën Vetting. Shpjegoj se shënimi i emrit tim në kontratat e sigurimit nuk mund të nënkuptojë se jam pronari i automjetit. Edhe me shpjegimet e mia të mëparshme kam arritur të provoj se vëllai im e ka blerë automjetin me burime të ligjshme. Të hollat që janë përdorur për blerjen e këtij automjeti janë të ardhura që rezultojnë nga paga dhe janë të taksuara, pavarësisht se janë marrë hua nga vëllai. Mosdokumentimi i datës së saktë të kthimit të huas në këtë rast, si gjetje e Komisionit, nuk qëndron, pasi të dyja palët në marrëdhënien e huas, përveçse kanë pranuar ekzistencën e huas, kanë pranuar që ajo shumë është kthyer. Huaja është kthyer përsëri pas vitit 2018 në deklaratimet që më kanë dhënë. Nuk jam dakord me konstatimin e Komisionit se automjeti është përdorur vetëm nga subjekti i rivlerësimit, vetëm e vetëm se nuk ka akte publike që të tregojnë përdorimin nga të tjerë persona. Automjeti është blerë nga vëllai im për t’u përdorur:*

- nga ai kur vinte në Shqipëri;

- nga prindërit për nevojat e tyre ... Automjeti është përdorur edhe nga vëllai tjetër J., qoftë për shkak të punës, qoftë për udhëtime të tjera brenda vendit;

- automjeti ka qëndruar në Tiranë tek përdoruesit e tij të zakonshëm, që janë prindërit dhe vëllai tjetër. Prindërit i ka shoqëruar vëllai J. si shofer në udhëtimet e tyre dhe në mungesë të tij babai ka shkuar me shokë që kanë leje drejtimi për automjet.

Vëllai K., duke ditur edhe pritshmëritë e të ardhurave që do të merrte për shkak të profesionit që ka zgjedhur, si dhe duke marrë në konsideratë mundësitë e kushëririt për të dhënë hua, si dhe për të mos i kërkuar ato për një periudhë 7-8 vjeçare, ka menduar që të kryejë një blerje të tillë. Dyshimi i Komisionit se automjeti është i subjektit të rivlerësimit dhe unë e kam fshehur atë nuk duhet të mbështetet vetëm në faktin e përdorimit të automjetit për një kohë të gjatë, pa kundërshpërblim dhe pa ndërprerje. Shpjegoj se unë e kam përdorur automjetin dhe kjo marrëdhënie përmbush elementet e kontratës së huapërdorjes. Ky automjet është përdorur nga ana ime për daljet jashtë shtetit sidomos për periudhën 2015 – 2017, ku daljet kanë qenë më të shtuara se në periudhën 2010 – 2014, ku rezultoj se kam dalë vetëm 1 herë. Ky automjet është përdorur brenda territorit shqiptar nga unë, sigurisht i lidhur me momentin kur kam dalë jashtë shtetit.

Sa i takon gjetjes së Komisionit se mbetet e dyshimtë se automjeti është blerë nga vëllai tjetër me prokurë dhe është dhënë po nga ai në huadhënie subjektit të rivlerësimit, shpjegoj se automjeti është me prokurë për shkak se në momentin kur është gjetur, blerësi nuk ka qenë në Shqipëri dhe ka biseduar me vëllain tjetër Jetlirin që të veprojë në bazë të prokurës së datës 17.11.2009, që i kishte lënë më parë, ku përfshihej dhe shitblerja e automjeteve.

Në përfundim, duke qenë se vërtetohet burimi i ligjshëm për krijimin e pasurisë dhe përdorimi i këtij automjeti edhe nga familjarët e tjerë, kërkoj nga Komisioni që të mos e konsiderojë këtë pasuri si të fshehur nga ana ime”.

186. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij edhe një deklaratë noteriale të babait dhe të vëllait të tij J. A..

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

187. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

188. Në vlerësim të faktit se subjekti ka një marrëdhënie përdorimi të dokumentuar për gati 7 vjet të kësaj pasurie të luajtshme, marrëdhënie e cila nuk është deklaruar në përputhje me përcaktimet ligjore në deklaratimet vjetore pranë ILDKPKI-së, ka fshehur ekzistencën dhe deklarimin e burimit të pagesës së kryer për blerjen e këtij automjeti.

189. Trupi gjykues vëren se ka mospërputhje në deklarime lidhur me kohën e marrjes së huas nga shtetasi Gj. A., i cili në deklaratën e datës 4.11.2020 deklaroi se: “... në vitin 2009 dhe 2010 i dhashë hua një shumë totale prej 15.000 GBP pa interes, K. A. t...”, ndërsa subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore në lidhje me huan e pretenduar të marrë nga vëllai shtetasi Gj. A., ndër të tjera, ka deklaruar se realisht kjo është marrë hua në vitet 2010 - 2011.

190. Pra, në kushtet kur shtetasi K. A. në mars të vitit 2010 i dha subjektit një hua në vlerën 10.000 euro, nuk arrin ta justifikojë me burime të ligjshme, 6 muaj më pas, blerjen e një automjeti në shumën 17.000 euro.

191. Nisur nga fakti se të ardhurat e këtij shtetasi në shtetin çek fillojnë pas tetorit të vitit

2010, Komisioni vlerëson se subjekti, duke pasur të pamundur të dokumentojë burimin e të ardhurave të vëllait të tij për blerjen e kësaj pasurie në përdorim të tij, ka bërë përpjekje për të transferuar ligjshmërinë e shumës së blerjes së këtij automjeti tek të tretë.

192. Në lidhje me pretendimet për përdorimin e këtij automjeti nga familjarët, persona të tjerë të familjes, trupë gjykues, pasi administroi në cilësinë e provës deklaratën noteriale të babait dhe vëllait të subjektit, duke e vlerësuar në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë procesit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerëson se nuk janë bindëse shpjegimet e tij, pasi jo vetëm nuk rezulton i provuar me ndonjë akt në dosje⁶⁸ përdorimi prej tyre i këtij automjeti, por subjekti nuk dha asnjë arsye bindëse se përse vëllai, që ndodhej me studime jashtë vendit, pavarësisht mungesave financiare të tij, duhet të blinte një automjet, i cili nga momenti i blerjes do t'i lihej në përdorim vëllait të tij.

193. Në rastin konkret, nga analiza që u bëhet të gjitha të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të provave sipas përcaktimeve të posaçme të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një sërë rrethanash, të cilat kanë rezultuar nga hetimi dhe që nuk mund të injorohen e të konsiderohen si joekzistente në kushtet kur burojnë nga burime të njohura të provës, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 49, të neneve 32, të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të çmuara në raport me njëra-tjetrën, si mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të shtetasit K. A. , faktin se ky automjet, që nga momenti i blerjes, është provuar me dokumentacion se është përdoruar dhe zotëruar nga subjekti i rivlerësimit, i cili është sjellë si pronar i këtij automjeti, duke mos deklaruar në asnjë vit të drejtat reale të përdorimit të tij, të çojnë në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit është kryer fshehje e kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

194. Në vijim, duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e pranuar prej subjektit të rivlerësimit që konsistojnë në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara dhe, nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë, në kuptim të parashikimeve të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Blerje garazhi (2 copë), në “**”, pallati “****”**

195. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se këto garazhe janë përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. ***, datë 27.1.2017, në vlerën 10.000 euro, me burim krijimi nga kursimet.

196. Në DPV-në e vitit 2017, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar: “*Blerje garazhi (2 copë), ndodhur në ‘****’, pallati ***, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.1.2017, në shumën 10.000 euro. Burimi i krijimit: kursimet*”.

⁶⁸Pranuar edhe nga subjekti në seancën dëgjimore.

197. Në bazë të kontratës së shitblerjes⁶⁹ nr. ***, datë 27.1.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasin Desart Avdulaj, është kryer shitja e pasurive të paluajtshme të llojit “garazh” dhe kalimi i titullit të pronësisë nga shitësi tek blerësi për:

- pasurinë e llojit “garazh” nr. ***, me sip. 12.5 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në “****”, Tiranë;

- pasurinë e llojit “garazh” nr. ***, me sip. 12.5 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. 53, në “****”, Tiranë.

199. Çmimi i shitjes, referuar nenit 3 të kontratës, është përcaktuar nga 5.000 euro për çdo pasuri, në total 10.000 euro. Për mënyrën e likuidimit, referuar kontratës, palët kanë rënë dakord që likuidimi i shumës totale të bëhet duke u derdhur në llogarinë përkatëse të noteres.

200. Referuar informacioneve të disponuara nga Komisioni⁷⁰ rezulton se në datën 27.1.2017, nga shtetasi Desart Avdulaj është paguar shuma prej 10.000 euro në “Tirana Bank”, me përshkrimin “pagim total blerje garazhi sipas kontratës nr. ****”.

201. Analiza financiare për mundësinë e subjektit për blerjen e këtyre pasurive, mbi bazë të burimit të të ardhurave të deklaruar, është kryer së bashku me shpenzimet/investimet e deklaruar, si dhe gjendjet *cash* në banesë në datën 28.1.2017, në shumën 1.500.000 lekë, pasqyruar më poshtë.

a) Sistem kondicionimi për apartamentin në “**”, p. “****”, shk. ***, objekti ***, ap. ****, k. ****, Tiranë**

202. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* faturën tatimore nr. ***, datë 27.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k. Tiranë, në shumën 1.367.800 lekë, me burim krijimi nga kursimet.

203. Në DPV-në e vitit 2017, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar: “*Sistem kondicionimi për apartamentin në ‘****’, pallati ‘****’ fatura tatimore nr. ****, datë 27.1.2017, nga ‘****’ sh.p.k., Tiranë, shuma 1.367.800 lekë, burimi i krijimit, kursime*”.

204. Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ndër të tjera, ka bashkëlidhur edhe faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 27.1.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Desart Avdulaj, për blerje sistem kondicionimi për apartament, në shumën 10.000 euro, e konvertuar në vlerën 1.367.800 lekë.

205. Subjekti, lidhur me kohën dhe mënyrën e shlyerjes së shumës 1.367.800 lekë⁷¹, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: “*Pagesa për kondicionimin e shtëpisë më është mbajtur në datën 27.1.2017 cash në ambientet e shitësit*”. Gjithashtu ka depozituar edhe mandatar këtimi nr. ***, datë 27.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k.

b) Gjendje cash në banesë, në shumën 1.500.000 lekë

⁶⁹Kontrata midis shoqërisë “****” dhe shtetasit Desart Avdulaj, pjesë e dosjes nr. *** të ILDKPKI-së.

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, e DPPP-së.

⁷¹Pyetësori nr. 3, pyetja 12.

206. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi: mbetur nga kursimet nga paga.

207. Nga analiza financiare paraprake e treguesve financiare e kryer nga Komisioni, deri në datën 31.12.2015, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të akumulujë likuiditete në gjendjen *cash* në banesë.

208. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “... *shtuar kursimet e ruajtura në shtëpi nga të ardhurat nga paga në shumën 1.200.000 lekë*”. Për sa i përket kursimeve të deklaruara si shtesë të gjendjeve *cash* në vitin 2016, nga analiza paraprake financiare e kryer konstatohet se ky vit rezulton me balancë negative fondesh në vlerën 54.891 lekë, kështu që shuma e llogaritur shtesë gjendje *cash* në këtë vit do të pasqyrohet në vlerën 1.145.109 lekë (1.200.000 lekë -54.891 lekë).

Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për blerjen e 2 garazheve, investimin në sistemin e kondicionimit për apartamentin në “**”, si dhe gjendjet *cash* në banesë të deklaruara në deklaratën *Vetting*.**

209. Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë paraprakë për periudhën 1.1.2017 – 28.1.2017, për evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit mbi bazën e burimit të të ardhurave të deklaruara, për blerjen e dy garazheve në shumën 10.000 euro, shpenzimet/investimet e deklaruara në shumën 1.367.800 lekë, në datën 27.1.2017, si dhe kursimet në formën e likuiditeteve *cash* në banesë në datën 28.1.2017, në shumën 1.500.000 lekë, konkretisht:

Analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2017 – 28.1.2017	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet, subjekti i rivlerësimit	102.446
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblimet, bashkëshortja	55.783
Total të ardhura/të hyra financiare	158.229
Shpenzime për int. <i>overdrafti</i> dhe komisione bashkëshorte ABI Bank	2.274
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	21.207
Paguar shpenzime kondicionimi, fatura tatimore nr. ***, datë 27.1.2017	1.367.800
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së	36.196
Total shpenzime/të dala financiare	1.427.477
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	-354.891
Ndryshim mjete monetare bankë, dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-94.955
Mjete monetare të disponueshme (1)	-1.719.094
Blerje garazhe në datën 27.1.2017, në shumën 10.000 euro	1.365.700
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	1.365.700
Balanca e fondeve (1-2)	-3.084.794

210. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për pasuritë e llojit “garazh” (2 copë), në shumën 10.000 euro,

shpenzimet për sistemin e kondicionimit për apartamentin në “****”, referuar faturës tatimore nr. ***, datë 27.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k., likuiditetet e deklaruara në gjendje *cash* në shumën 1.500.000 lekë, në datën 28.1.2017, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2017 – 28.1.2017 (balanca negative në vlerën 3.084.794 lekë).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

211. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në ndryshim nga konstatimi i Komisionit që gjendjen cash në fund të vitit 2016 e ka llogaritur 1.145.109 lekë, nga analiza e bërë pas ndryshimeve që reflektojnë pretendimet e mia rezulton se gjendja e likuiditeteve në banesë më 31.12.2016 të ketë qenë 4.046.019 lekë”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

212. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, duke i vlerësuar me paanësi dhe objektivitet⁷², vlerëson se subjekti nuk ka arritur të shpjegojë dhe provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me rezultatet e hetimit lidhur me burimet financiare të deklaruara për blerjen/krijimin e këtyre pasurive/investimeve, duke mos justifikuar me burime financiare të ligjshme të ardhurash pagesën e kryer për pasuritë e llojit “garazh” (2 copë), në shumën 10.000 euro, shpenzimet për sistemin e kondicionimit për apartamentin në “****”, referuar faturës tatimore nr. ***, datë 27.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k., si dhe likuiditetet e deklaruara në gjendje *cash* në datën 28.1.2017, në shumën 1.500.000 lekë.

213. Në përfundim të vlerësimit për këtë pasuri, rezultoi se subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë e të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të neneve 33 dhe pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Blerje automjet gjahu tip “Mitsubishi”, prodhim anglez, viti 1999

214. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: *“Blerë me kontratën nr. ***, datë 12.8.2014, në vlerën 200.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga”*.

215. Në DPV-në e vitit 2014, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerje automjet gjahu ‘Mitsubishi Shogun’ me kontratë në datën 12.8.2014, në Gjirokastrë, në shumën 200.000 lekë”*.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

216. Referuar të dhënave nga DSHPTRR-ja⁷³, ky automjet është marrë në datën 13.1.2009 në Angli, nga shtetasi A. Z., si dhe është zhdoganuar me DAV, nr. ***, datë 9.2.2009, duke

⁷²Pasqyruar edhe më lart.

⁷³Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2020.

u shlyer detyrimet doganore në shumën 332.284 lekë. Certifikata e pronësisë së këtij automjeti është lëshuar nga DRSHTRR-ja Gjirokastër datë 11.2.2009.

217. Me kontratën e huapërdorjes, datë 16.2.2009, shtetasi A. Z. i ka dhënë për përdorim subjektit automjetin tip “Mitsubishi Shogun”, vit prodhimi 1999, me targa ***, për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që në rast se huadhënësi i kërkon automjetin huamarrësit, në çdo kohë afati quhet i mbaruar.

218. Regjistrimi i këtij automjeti është bërë në datën 11.2.2009, pra disa ditë përpara kontratës së huapërdorjes, i është kërkuar subjektit të rivlerësimit⁷⁴ të shpjegojë nëse është përdorur ky automjet nga pronari i tij për periudhën 11.2.2009 – 12.8.2014, sa ka qenë vlera e blerjes dhe të provojë burimin e ligjshëm të kësaj pasurie nga ky shtetas, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

219. Gjithashtu, me kontratë shitjeje automjeti datë 12.8.2014, subjekti ka blerë nga shtetasi A. Z. automjetin tip “Mitsubishi Shogun”, vit prodhimi 1999, me targa ***, kundrejt çmimit 200.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

220. Referuar fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me automjetin e gjahut tip “Mitsubishi”, për sa ka rezultuar se ky automjet ka qenë në përdorim të subjektit të rivlerësimit nga momenti i regjistrimit të tij në vitin 2009 dhe më pas është deklaruar i blerë në vitin 2014, kundrejt çmimit prej 200.000 lekësh, ndonëse pretenduar i papërdorur për 3 vjet.

221. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 (pjesore), subjekti ka deklaruar se: *“Sa i përket përdorimit të automjetit, veç përdorimit nga pronari rezulton se është përdorur edhe nga të afërmit e tij, si dhe nga një person juridik privat. Bashkëngjitur po ju dërgoj deklaratat noteriale”*.

222. Në dokumentacionin e dërguar në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka dorëzuar, ndër të tjera, edhe një vërtetim të datës 22.12.2020, të noterit B. A., i cili vërteton se: *“Në këtë datë është paraqitur shtetasi J. Ç., i cili ka kërkuar nga arkivi noterial dhe të vërtetohet njësisë me origjinalin e kontratës së shitjes së automjetit nr. ***, datë 2.4.2010, ku J. Ç. është në cilësinë e ‘palës blerëse’, ndërsa A. S. Z. është në cilësinë e ‘palës shitëse’ të një automjeti me këto karakteristika ‘Mitsubishi Shogun’, vit prodhimi 1999, ngjyra blu, me targa ***”*.

223. Noteri deklaron se nuk e disponon këtë kontratë, pasi ka kaluar afati ligjor i ruajtjes prej 10 vjetësh në arkiv, ka fotokopjuar faqen 27 të regjistrit të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale, ku pasqyrohet kontrata e shitjes së automjetit sa më lart.

224. Ndërsa, në përgjigjet shtesë të këtij pyetësori dërguar Komisionit në datën 19.1.2021, subjekti ka deklaruar se: *“Sa i përket vlerës së blerjes së automjetit, shtetasi A. Z. nuk ka mundësi objektive të gjejë dokumentin justifikues të vlerës së tij, për shkak të kalimit të kohës së gjatë. Më ka deklaruar se vlera mund të ketë qenë rreth 2.000 GBP, por jo me siguri të plotë. Sa i takon burimit të të ardhurave, automjeti është blerë me të ardhurat nga puna. Bashkëngjitur po ju paraqes formularin e të ardhurave vjetore nga puna (prill 2008 – prill*

⁷⁴Pyetësor nr. 3.

2009)”.

225. Referuar këtyre formularëve (vetëm të përkthyer në gjuhën shqipe), të ardhurat për vitin tatimor deri më 5.4.2009 janë në vlerën 22.301 GBP dhe taksa e redaktuar është 2.364 GBP.

226. Komisioni vlerësoi se aktet e administruara në dosje nuk vërtetojnë/dokumentojnë shumë e paguar për blerjen e këtij automjeti, si dhe nuk provojnë të ardhurat dhe mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur A. Z., për blerjen e tij dhe pagesën e detyrimeve doganore etj., në vitin 2009.

227. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

i) Shtetasi A. Z. nuk arrin të justifikojë me të ardhura nga burime të ligjshme blerjen, zhdoganimin dhe regjistrimin e automjetit tip “Mitsubishi”, i cili ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit dhe më pas është blerë nga ky i fundit.

ii) Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit, deklarimeve të subjektit, referuar fakteve, trupi gjykyes vlerëson se referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për konfliktin e interesave në ushtrimin e detyrës dhe shpjegimeve lidhur me rrethanat e shitblerjes së automjetit tip ‘Mitsubishi’ përbëjnë shkelje të etikës nga subjekti i rivlerësimit, për sa sjellja e tij bie ndesh me atë që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

228. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“I qëndroj shpjegimeve të mia që unë jam vetëm një nga përdoruesit e automjetit, pasi ai është përdorur nga të afërmit e tjerë të tij brenda Republikës së Shqipërisë. Unë e kam përdorur vetëm për daljet jashtë shtetit duke filluar nga data 21.2.2009 - 17.3.2010, pavarësisht se afati i huapërdorjes ka qenë për 3 vjet. Pas datës 17.3.2010 nuk kam dijeni se çfarë është bërë më këtë automjet, pasi pas kësaj date kam përdorur për daljet jashtë shtetit automjetin në emër të vëllait tim K. A. me targa ***. Më pas, në datën 17.4.2020 ky automjet rezulton i shitur te shtetasi J. Ç.. Shitjen e automjetit te ky shtetas e kam marrë vesh vetëm kur ju paraqita deklaratën noteriale të tij dhe bashkëngjitur edhe vërtetimin nga noteri, i cili nuk ka mbajtur kopje të kontratës për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar. Sa i përket konstatimit tuaj për këtë mënyrë të veprimeve mbi këtë automjet, shpjegoj se në momentin kur kam blerë automjetin në vitin 2014 nuk kam qenë në dijeni të kontratës së datës 17.4.2020. Në lidhje me këtë fakt, mund të shpjegoj se në rastin konkret, edhe pse është përfunduar kontrata e shitjes me blerës shtetasin J. Ç., duke qenë se nuk është bërë pagesa e gjithë çmimit të rënë dakord mes palëve, kontrata nuk mund të sjellë efekt dhe kanë qenë vetë palët që nuk kanë bërë veprime të mëtejshme tek Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër. Përderisa në kontratë nuk është paguar çmimi tërësor dhe në afatin e duhur kontrata nuk mund që të sjellë efekte dhe konsiderohet sikur nuk është bërë. Për më tepër që në rastin konkret personi juridik ku është përdorur automjeti ka rezultuar një mashtrues, si për sa i përket peronave të punësuar, ashtu edhe sa i përket veprimeve të tjera financiare, ku përfshihet edhe shitblerja e automjetit. Për këtë*

*situatë është dhënë për referencë edhe vendimi penal nr. ***, datë 28.10.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.*

Në vitin 2014, pas 4 vjetësh nga përdorimi i fundit i automjetit, A. ka dashur që ta shesë për shkak se po bënte 3 vjet automjeti i papërdorur. Kam rënë dakord për blerjen e tij në shumën 200.000 lekë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar automjeti si i papërdorur pasi është marrë nga personi juridik ku është shitur në vitin 2010. Taksat për qarkullimin e automjetit janë paguar në mënyrë të menjëhershme për periudhën e prapambetur 3-vjeçare dhe më pas është bërë kontrata e shitblerjes. Taksat për vitet 2012 - 2014 i janë paguar nga pronari në datën 31.7.2014, të cilat po jua paraqes si provë.

Komisioni e ka gjetur çmimin e shitjes të ulët. Ndryshe nga kjo gjetje, vlerësoj se çmimi i blerjes nga unë është normal, pasi kemi të bëjmë me një automjet me timon anglez, i papërdorur për 3 vjet dhe i lënë në ambient të hapur për të gjithë këtë periudhë. Me shtetasin A. Z. unë nuk kam pasur konflikt interesi, kam pasur njohje dhe çmimi i caktuar në kontratën e datës 12.8.2014 është i pandikuar nga ndonjë faktor tjetër. Çmimi i shitjes së automjetit nuk mund të jetë i njëjtë edhe pasi kanë kaluar 5 vjet nga përdorimi i tij.

Sa i përket gjetjes nga Komisioni 'Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit, deklarimeve të subjektit dhe referuar fakteve mbi automjetin e gjahut tip 'Mitsubishi' në përdorim, trupi gjykues vlerëson t'i kërkojë shpjegime subjektit të rivlerësimit për kujdesin e treguar nga ai që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron', shpjegoj se nuk kam shpërdorur funksionin, pasi kam përdorur automjetin e një personi të njohur dhe që nuk kam qenë në konflikt interesi. Duke qenë nip i personave që unë njoh dhe duke qenë një person që nuk ka pasur probleme me agjencitë ligjzbatuese kam vlerësuar se përdorimi i automjetit nuk përbën shkelje nga ana ime".

229. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: "Sa i takon çmimit të blerjes së automjetit 'Mitsubishi Shogun' në vitin 2009 nga shtetasi A. Z., shpjegoj se jam në pamundësi objektive t'ju paraqes çmimin e blerjes. Unë si subjekt i rivlerësimit nuk kam mundësi tjetër për ta paraqitur, për sa kohë personi që e ka blerë nuk e disponon faturën apo mandatpagesën e blerjes së automjetit. Në këto kushte, në bazë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 nuk kam ndonjë rrugë tjetër për të marrë dokumentin e blerjes. Sa i përket burimit të ligjshëm të blerjes, rezulton se çmimi i deklaruar nga shtetasi A. Z. është rreth 2.000 GBP dhe të ardhurat e përdorura për blerjen e automjetit dhe të pagimit të taksës doganore janë të ardhurat nga puna. Bashkëngjitur po ju dërgoj formularin e të ardhurave nga puna të shtetasit A. Z. për periudhën prill 2008 – prill 2009, të apostiluar që në muajin janar 2021. Gjithashtu, shtetasi A. Z. më ka dërguar edhe formularët e të ardhurave nga puna për periudhën prill 2005 – prill 2008, të pa apostiluar, pasi kërkohet ende kohë për marrjen e vulës apostile. Kështu që po jua dërgoj vetëm të përkthyer nga gjuha angleze, pasi dokumenti është në proces apostilimi dhe më nevojitet më tepër kohë për paraqitjen e tij. Nga të dy këto dokumente të ardhurash rezulton se A. Z. ka pasur të ardhura në periudhën prill 2005 – prill 2009, shumën 80.538 GBP dhe 11.924 GBP taksa të zbritshme. Shtetasi A. Z. ka qenë i vetëm në këtë periudhë dhe ka pasur vetëm shpenzimet bazike për jetesë, siç më konfirmon dhe siç shihet nga tabela më poshtë

rezulton se ka pasur mundësi që të blejë automjetin 'Mitsubishi' dhe të paguajë gjithashtu taksën doganore për të”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

230. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, duke i vlerësuar me paanësi dhe objektivitet, arsyeton se:

231. Ky automjet ka qenë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, disa ditë pas zhdoganimit dhe regjistrimit të tij, dhe nuk rezulton të jetë përdorur nga pronari i tij për shkak të qëndrimit në Angli, Komisioni, në bazë të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, automjetin tip “Mitsubishi Shogun”, vit prodhimi 1999.

232. Neni 681 i Kodit Civil, i cili parashikon se kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si edhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës, vlera e provuese e kontratës së shitblerjes duhet të vlerësohet dhe çmohet duke e interpretuar atë sipas qëllimit të palëve.

233. Organet e rivlerësimit kanë pranuar në jurisprudencën e tyre të konsiderojnë të pavërteta elementet e deklaruara në kontrata të ndryshme në të cilat kanë marrë pjesë subjektet e rivlerësimit, pavarësisht faktit se ato kanë qenë deklarime të bëra para një noteri publik dhe nuk kanë qenë kontestuar prej palëve, pikërisht se për shkak të veçorisë së këtij procesi, jo me natyrë civile të pastër, vlerësimi dhe gjykimi i çështjeve mund të bëhet në zbatim të normave procedurale të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të zbatueshme në përputhje me parashikimin referues që bën pika 6, e nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

234. Në këtë kontekst duhen konsideruar edhe dispozitat e Kodit Civil për interpretimin e kontratave, për sa kohë që palët deklarojnë një qëllim të caktuar në përpilimin e tyre në formën dhe përmbajtjen që rezulton se kanë, edhe për shkak se ky qëllim i deklaruar i palëve nuk mbështetet nga të dhënat e përftuara nëpërmjet burimeve të tjera të provës.

235. Paraqitja e vërtetimit të noterit nga subjekti, që ky automjet i është shitur shtetasit Julian Çoku në datën 2.4.2010 nga shtetasi A. Z., vjen në kundërshtim edhe me sa ka rezultuar referuar kontratës së shitjes të datës 12.8.2014, sipas së cilës është shtetasi A. Z. që ia shet subjektit të rivlerësimit këtë automjet.

236. Kontrata e shitblerjes e lidhur mes palëve para autoritetit publik si noteri në rastin konkret, duket si përpjekje e subjektit për të fabrikuar këto akte.

237. Në vijim të këtij arsyetimi, gjendet i pabesueshëm edhe shpjegimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë për sa i përket lidhjes se disa kontratave të shitjes, me palë të ndryshme lidhur me këtë pasuri të luajtshme.

238. Në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti nga shtetasi A. Z., Komisioni vëren se deklaratimet e dhëna nga subjekti për çmimin e blerjes së këtij automjeti në Angli në vlerën 2.000 GBP, nuk përputhen me deklarinimin e bërë nga ky shtetas në doganë në datën 9.2.2009, ku është deklaruar 1 euro çmimi i blerjes së këtij automjeti.

239. Për sa i përket burimit të të ardhurave dhe mundësisë financiare të shtetasit A. Z. për blerjen, zhdoganimin dhe regjistrimin e këtij automjeti, trupi gjykues konstaton se në prapësimet e tij subjekti ka llogaritur një kursim në shumën 19.936 GBP nga shtetasi A. Z., nga punësimi në Angli për periudhën 2006 – 2009. Të ardhurat për vitin tatimor deri më 5.4.2009, janë në vlerën 22.301 GBP dhe taksa e redaktuar është 2.364 GBP, për të cilin subjekti ka llogaritur një mundësi kursimi prej 7.204 GBP.

240. Nëse do të merrej në konsideratë shuma e blerjes dhe e zhdoganimit të këtij automjeti, mbështetur në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar afërsisht në vlerën 4.200 GBP (2.000 GBP + 2200 GBP shpenzime zhdoganimi) në shkurt të vitit 2009, edhe pse të ardhurat janë llogaritur deri në datën 5.4.2009, Komisioni vlerëson se blerja dhe zhdoganimi i një pasurie të cilën nuk e përdor, për më tepër e jep në përdorim tek subjekti i rivlerësimit pa ndonjë shpërblim, nuk justifikon si logjikisht, ashtu edhe financiarisht një shpenzim prej rreth 25% të të ardhurave vjetore⁷⁵ nga puna në emigracion në Britaninë e Madhe të shtetasit A. Z..

241. Në çështjen konkrete, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, pasi ai është ekspozuar në një marrëdhënie shitblerjeje, në mënyrë të përsëritur për automjetin “Mitsubishi Shogun”. Ekspozimi i subjektit të rivlerësimit në këtë lloj marrëdhëniesh është bërë me qëllim që në finale të konfirmohet ligjërisht si pronar i vërtetë i automjetit, pasi *de facto* ishte që në momentin e ardhjes së këtij automjeti në Shqipëri.

242. Pika 5, e nenit 3, të ligjit nr. 96/2016 përcakton se: *“Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”*.

243. Gjithashtu, në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se: *“Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare”*.

244. Mund të përmendim këtu një ndër parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit, pikën 4.9 që parashikon se: *“Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtari të familjes së tij, apo të kujtdo tjetër dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”*.

245. Shpjegimet në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, mundësinë financiare të shtetasit A. Z., mospërdorimit nga pronari legal i tij për shkak të qëndrimit në Angli, si dhe përdorimin e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit disa ditë pas zhdoganimit, bëjnë që Komisioni të arrijë në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit është kryer fshehje e kësaj

⁷⁵Ndërsa për periudhën 2005 – 2008 është gati sa vlera e kursimeve në vit referuar analizës së bërë nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

pasurie në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe gërmës “c”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pasuri të krijuara në vitin 2011

- **Armë gjahu, blerë më 8.3.2011, në shumën 114.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat.**

- **Automjet tip “Renault Clio”, blerë më 23.4.2011, në shumën 420.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga.**

246. Në DPV-në e vitit 2011, në ndryshim të interesave private pasuri të paluajjtshme dhe të luajjtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerje armë gjahu automatike, blerë nga ‘***’ sh.p.k., Fier, me faturë tatimore nr. ***, datë 8.3.2011, në shumën 114.000 lekë, me TVSH”*.

247. Shoqëria “***” sh.p.k., me faturën tatimore nr. ***, datë 8.3.2011, më NIPT ***, i ka shitur subjektit të rivlerësimit një armë gjahu “teke italiane”, kundrejt vlerës 114.000 lekë, me TVSH.

248. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: *“Blerë në datën 23.4.2011, me faturën tatimore nr. ***, Durrës, nga personi fizik I. T., në shumën 420.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga”*.

249. Në DPV-në e vitit 2011, në ndryshim të interesave private pasuri të paluajjtshme dhe të luajjtshme, subjekti ka deklaruar: *“Blerje autoveture tip ‘Renault Clio’, viti 2000, me faturën tatimore nr. ***, datë 23.4.2011, në shumën 420.000 lekë me TVSH”*.

250. Referuar faturës së shitjes nr. ***, datë 23.4.2011⁷⁶, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë nga shitësi I. T., i regjistruar, me objekt aktiviteti “tregtim automjesh dhe pjesë këmbimi të përdorura automjesh”, automjetin tip “Renault Clio”, viti i prodhimit 2000, për vlerën 420.000 lekë.

251. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, konfirmon automjetin me targa ***, në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes.

252. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti të ardhura nga paga, ndërsa në DPV-në e vitit 2011 nuk është deklaruar burimi përkatës i të ardhurave.

253. Ndonëse në deklaratën *Vetting* është deklaruar burim i të ardhurave nga paga, nuk është sqaruar nëse bëhet fjalë për të ardhurat nga paga në vitin 2011 apo janë përfshirë edhe kursime të mbartura nga viti paraardhës (me burim edhe këto nga paga e subjektit).

254. Në këto kushte, në vlerësim edhe të faktit se në vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe blerje/krijim të pasurive të tjera, shtesa në vlera monetare, si dhe transferta në llogari të vëllait K. A., Komisioni vendosi që analizën e treguesve financiarë për këto pasuri ta kryejë për të gjithë vitin e mbyllur 2011, dhe jo për çdo pasuri të veçantë.

Analiza e treguesve financiarë për pasuri të krijuara në vitin 2011

⁷⁶Pjesë e dokumentacionit të dosjes së ILDKPKI-së, f. ***.

255. Duke vlerësuar faktin se në deklaratën *Vetting* është deklaruar burim i të ardhurave nga paga, për blerjen e automjetit tip “Renault Clio”, si dhe të ardhurat për blerjen e armës së gjahut, por pa u shpjeguar nëse bëhet fjalë për të ardhurat nga paga në vitin 2011 apo janë përfshirë edhe kursime të mbartura nga viti paraardhës (me burim edhe këto nga paga e subjektit), Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, kreu një analizë financiare paraprake lidhur me mundësinë e subjektit për blerje/krijim pasurish, shtesa në likuiditete, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011⁷⁷, nga e cila duket se subjekti ka pasur pamundësi financiare që me të ardhurat e vitit 2011 të shtonte pasuri dhe të kryente shpenzimet për këtë vit në një vlerë negative prej 1.326.811 lekësh.

256. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se edhe nëse përfshihen në analizë likuiditetet gjendje *cash* në banesë, të akumuluar deri në datën 31.12.2010, që sipas llogaritjeve të Komisionit (të pasqyruara edhe më sipër)⁷⁸ duket se janë në vlerën 1.281.863 lekë, përsëri nuk kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Renault Clio” në vlerën 420.000 lekë, blerjen e armës së gjahut në vlerën 114.000 lekë, shtesën e deklaruar në likuiditete *cash* në vlerën 450.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për vitin 2011.

257. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se referuar burimit të deklaruar të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e automjetit tip “Renault Clio” në vlerën 420.000 lekë, blerjen e armës së gjahut në vlerën 114.000 lekë, shtesën e deklaruar në likuiditete *cash* në vlerën 450.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për vitin 2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

258. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Me burimin e krijimit të pasurive ‘të ardhurat nga paga’ dhe ‘të ardhurat’ kam dashur të them jo vetëm të ardhurat nga paga në kuptimin e ngushtë të fjalës për periudhën 1 janar – 8 mars 2011 apo 1 janar – 23 prill 2011, por dhe të ardhura të viteve të mëparshme. Kthimi i shumës 10.000 euro vëllait, e konvertuar në lekë në shumën 1.379.600 në vitin 2011 në dy këste, si hua e marrë por e pakonsumuar nga unë në vitin 2010, dhe pse nuk është deklaruar gjendje në fund të vitit 2010, vlerësoj se nuk duhet që të zbritet në mënyrën e llogaritur nga Komisioni. Mosdeklarimi si gjendje në fundvitin 2010 mund të përbëjë një pakujdesi timen në plotësimin e deklaratës, por kam menduar se ka qenë i mjaftueshëm deklarimi në vitin pasardhës se huaja nuk është përdorur qoftë për destinacionin e saj për studime master, qoftë për blerjen e ndonjë pasurie tjetër. Duke qenë se huaja e marrë në vitin 2010 është kthyer në vitin 2011, duke shërbyer po e njëjta shumë si likuiditet, kërkoj që të merrni në konsideratë qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 28, datë 23.10.2020 (JR): ‘... nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklarimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision se subjekti ka përdorur pasurinë e tij likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë*

⁷⁷Pasqyruar edhe në pikën 1.1.

⁷⁸Viti 2007, shuma 200.000 lekë; viti 2008, shuma 81.863 lekë; viti 2009, shuma 500.000 lekë dhe viti 2010, shuma 500.000 lekë.

shpenzim përgjatë periudhës që i është nënshtruar kontrollit. Në këto kushte, kur shpenzimi apo përdorimi i këtyre pasurive, të deklaruar cash e të justifikuar ligjërisht, nuk ka shërbyer si burim krijimi për asnjë pasuri të krijuar prej subjektit apo për të përballuar ndonjë transaksion financiar të kryer prej tij, situatë faktike e cila do të kërkonte domosdoshmërisht saktësinë e deklarimeve periodike të subjektit për vlerën e kësaj pasurie, sipas kërkesës së pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se pasaktësia e këtyre deklarimeve nuk afekton verifikimin e ligjshmërisë së burimit për të gjitha pasuritë e subjekti''.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

259. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklarimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, vlerëson të theksojë se huadhënësi, vëllai i subjektit, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë hua shumën 10.000 euro.

260. Trupi gjykues arrin në përfundimin se shuma prej 10.000 eurosh, e cila pretendohet të këtë qenë gjendje *cash* në fund të vitit 2010, nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2010 si gjendje *cash*.

261. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerëson se bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurisë, deklaratat periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit.

262. Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2010 vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, për të provuar deklarimet e subjektit mbi gjendjen *cash*. Në analizë të deklaratës periodike të vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar se ka pasur gjendje *cash*.

263. Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, si dhe deklarimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

264. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota.

265. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

266. Kolegji i Posaçëm i Apelimit orienton Komisionin se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...].”*

267. Shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk mbështeten në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik dhe duke i vlerësuar ato me sa ka rezultuar nga hetimi administrativ se huadhënësi, vëllai i subjektit, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë hua shumë 10.000 euro, arrin në konkluzionin se subjektit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës se provës⁷⁹ për pamundësi financiare për blerjen e automjetit tip “Renault Clio” në vlerën 420.000 lekë, blerjen e armës së gjahut në vlerën 114.000 lekë, shtesën e deklaruar në likuiditete *cash* në vlerën 450.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për vitin 2011.

6. Pasuri dhe aktivitete të tjera fitimprurëse të padeklaruara në DPV-të përkatëse

i) Në lidhje me pasuritë e padeklaruara

268. Referuar informacionit nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, zyra Mallakastër⁸⁰, rezulton se në emër të subjektit dhe prindërve janë të regjistruara pasuri të paluajtshme tokë bujqësore, të përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, në bashkëpronësi me 1/6 pjesë takuese për pasuritë si vijojnë:

- pasuria e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 1800 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në fshatin D., Njësia Administrative F.;
- pasuria e llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe totale 106.26 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në fshatin D., Njësia Administrative F.;
- pasuria e llojit “pemëtore”, me sipërfaqe totale 301 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në fshatin D., Njësia Administrative F.;
- pasuria e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 866 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e ndodhur në fshatin D., Njësia Administrative F..

269. Bashkëlidhur edhe certifikatë familjare nr. ***, datë 8.6.2015, ku konfirmohet përbërja nga 6 anëtarë të trungut familjar të familjes Avdulaj në datën 1.8.1991, ku subjekti është i cituar si i biri i kryefamiljarit, shtetasit B. A.

270. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit se nuk ka deklaruar pjesë takuese në këto pasuri të paluajtshme, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet përkatëse, për të cilën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

⁷⁹Edhe pas ndryshimeve/marrjes në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për vitin 2008.

⁸⁰Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2020.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

271. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... që prej datës 16.5.2002 kam hequr dorë nga të gjitha pasuritë e trajtuara me ligjin nr. 7501/1991, të AMTP-në nr. ***. Në këtë aspekt, vlerësoj se nuk kam pasur detyrim të deklaroj pasuritë nga të cilat unë kam hequr dorë”.

272. Subjekti ka bashkëlidhur si provë deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.5.2002, në të cilën heq dorë nga pronësia mbi pasurinë me kryefamiljar z. B. A. (babai i subjektit), të përfutur në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, me AMTP-në nr. ***, datë 10.5.1995.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

273. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, për sa i përket tokës bujqësore, arsyeton se:

274. Subjekti është bashkëpronar në këtë pasuri të paluajtshme referuar ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, sipas të cilit anëtarët e familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme, që ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para datës 19.7.1991 përfitonin nga ky ligj.

275. Kjo pasuri nuk është pjesëtuar sipas rregullave të Kodit Civil, shtuar nga neni 4, i ligjit nr. 42/2017, sipas pikës 2/1, 2 të të cilit: “Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1.8.1991, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të këtij kodi për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti”.

276. Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. 32/2019, arsyeton se: “... bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie, qëndrim ky i konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ...”.

277. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit me pjesë takuese ideale të kësaj pasurie, nuk kishte mundësi ligjore të hiqte dorë nga kjo pasuri. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit me pjesë takuese ideale të këtyre pasurive, ka kryer deklaratim të pasaktë pasi nuk i ka deklaruar këto pasuri.

Në lidhje me aktivitete/biznese të padeklaruara

278. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur nga DRT-ja Gjirokastrë⁸¹, rezulton se: “... shtetasja J. E. A. figuron në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, si person fizik në subjektin me NIPT ***, emri tregtar ‘***’ me datë regjistrimi 11.9.2013. Objekti i aktivitetit aktivitete juridike dhe statusi i tatimpaguesit 26.8.2014 data e statusit të tatimpaguesit”.

279. Në deklaratimin periodik vjetor të viteve 2013 dhe 2014, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ky aktivitet privat, për të cilin bazuar në nenin 52 të ligjit

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2020.

nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

280. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... ky mosdeklarim përbën një pakujdesi në DPV-të 2013 - 2014. Kam menduar se duke deklaruar të ardhurat nga qendra komunitare multifunksionale ka qenë i mjaftueshëm dhe i nënkuptuar edhe deklarimi i aktivitetit privat”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

281. Trupi gjykues vlerëson se në zbatim të germës “g”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur detyrimin për deklarim të: “... (g) angazhimeve në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdolloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdolloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim...”.

282. Në përfundim të vlerësimit, rezultoi se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me angazhimet e bashkëshortes në veprimtari private të regjistruara me qëllim fitimi në periudhën 2013 – 2014.

7. Në lidhje me konfliktin e interesave në ushtrimin e detyrës

283. Nga verifikimi për çështje të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë ndërgjyqëse dhe/ose personat e tjerë të lidhur, shoqëritë tregtare në të cilat kanë qenë në pozicionin e ortakut/administratorit, në datën 7.12.2020, u konstatua se: në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të gjykatës për çështjen gjyqësore nr. ***, regjistruar në datën 4.10.2019, me palë shoqërinë përmbarimore private “****” sh.p.k., me NIPT *** (detaje të çështjes civile), rezultonte gjyqtar subjekti i rivlerësimit dhe statusi i çështjes “përpunim”.

284. Gjykatës së Apelit Durrës⁸² i është kërkuar informacion në lidhje me çështje gjyqësore të regjistruara/shqyrtuara për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2019, me palë ndërgjyqëse dhe/ose: shtetasi A. K., shoqëria përmbarimore private “****” sh.p.k., me NIPT ***.

285. Në përgjigjen e saj kjo gjykatë⁸³, ndër të tjera, informon Komisionin se në emër të shoqërisë përmbarimore private “****” sh.p.k. (në cilësinë e palës së paditur dhe personit të tretë), rezultoi e regjistruar edhe çështja nr. ***, datë 4.10.2019, (bashkëlidhur fletët përkatëse të regjistrimit të çështjes në sistem). Referuar dokumentit të dërguar nga kjo gjykatë “informacion mbi çështjen”, rezultoi gjyqtar F. K..

286. Nisur nga fakti që të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të gjykatës, përpara shkresës nr. *** prot., datë 9.12.2020, të dërguar nga Komisioni, kishin mospërputhje me të dhënat e përcjella në përgjigjen e Gjykatës së Apelit Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020, si dhe atyre të publikuara më pas në këtë faqe, për të njëjtën çështje, nga Komisioni⁸⁴ iu kërkuar sërish kësaj gjykate informacion shoqëruar me dokumentacionin

⁸²Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e Komisionit.

⁸³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.12.2020.

⁸⁴Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2021.

përkatës lidhur me mënyrën e regjistrimit/shortimit, ecurinë e të gjitha akteve deri në datën 16.12.2020, si dhe pasqyrimin përkatës në faqen zyrtare të gjykatës për çështjen gjyqësore nr. ***, në datën 4.10.2019. Gjithashtu u vu në dijeni edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

287. Gjykata e Apelit Durrës⁸⁵, ku kryetar është subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, informoi Komisionin se: *Çështja civile është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës në datën 10.4.2019 dhe me short elektronik i ka kaluar për gjykim gjyqtarit T. H.. Në bazë të urdhrin nr. ***, datë 21.9.2020, të kryetarit të gjykatës, pika 3.3, për shkak të shkarkimit të relatorit T. H., çështja është rishortuar duke kaluar tek gjyqtari Desart Avdulaj.*

289. Pas caktimit të gjyqtarëve në skemën e delegimit z. F. K. dhe znj. I. H. për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Durrës, me qëllim barazinë e ngarkesës së punës të të gjithë gjyqtarët me vendimin nr. ***, datë 5.11.2020, të Këshillit të Gjykatës së Apelit Durrës, pika 3, është vendosur rishpërndarja me short e të gjitha çështjeve të planifikuara në gjendje deri në datën 5.11.2020, që kishin në ngarkim gjyqtarët Desart Avdulaj, etj. Në zbatim të vendimit më sipër, çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarit F. K..

290. Shpjegimet e subjektit mbi arsyet se përse ndodhej në faqen e gjykatës e regjistruar kjo çështje në emrin e tij, nuk janë bindëse. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti nuk ka përmbushur kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të parashikuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

291. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Sa i përket çështjes së konfliktit të interesit në Gjykatën e Apelit Durrës, në lidhje me çështjen civile nr. ***, regjistruar në datën 4.10.2019, me palë shoqërinë përmbartimore private ‘***’ sh.p.k., sqaroj se nuk është cenuar parimi i paanësisë dhe në veprimet e mia si subjekt nuk është kryer asnjë veprim nënveprim në kundërshtim me nenet 41-42 të Kushtetutës apo nenet 72-73 të Kodit të Procedurës Civile.*

Në lidhje me këtë çështje unë po jap sqarime për herë të parë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi përgjigjet zyrtare në emër të institucionit ku unë jam titullar janë përgatitur dhe konceptuar nga të tjerë persona dhe informacioni nuk më është kërkuar mua si subjekt i rivlerësimit. Në vijim ju sqaroj:

- i. Në sistemin ICMIS, dokumenti bazë që tregon çdo veprim për dosjen në sistem është i veprimeve (RIV), i cili paraqet numrin e veprimeve të kryera në çështjen përkatëse, me rend kronologjik, me datë dhe me orë.*
- ii. Referuar këtij të cilin po jua dërgoj bashkëngjitur si provë, rezulton se kjo çështje është regjistruar në datën 4.10.2019, dhe po këtë datë është shortuar elektronikisht tek gjyqtari T. H. (veprimet në RIV me numër rendor 1,8,9).*

⁸⁵Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.1.2021.

- iii. Pas shkarkimit të gjyqtarit T. H., të gjitha çështjet në ngarkim të tij u janë shpërndarë gjyqtarëve të tjerë të gjykatës në mënyrë të barabartë, me urdhrin nr. ***, datë 21.9.2020, të kryetarit të gjykatës. Në zbatim të këtij urdhri, çështja me nr. *** është shortuar elektronikisht tek unë si gjyqtar (veprimet në RIV me numër rendor 10,11).
- iv. Me vendimet nr. ***, datë 7.10.2020 dhe nr. ***, datë 27.10.2020, në Gjykatën e Apelit Durrës janë emëruar gjyqtarët I. H. dhe F. K.. Për të barazuar ngarkesën në punë dhe për t'i ndarë në trupa gjykues, Këshilli i Gjykatës, me vendimin nr. ***, datë 5.11.2020, ka ndarë gjyqtarët në trupa gjykuese dhe në pikat '3-3.5' është urdhëruar rishpërndarja e çështjeve të paplanifikuara nga gjyqtarët ekzistues. Në datën 10.11.2020 është mbajtur procesverbali përkatës, ku janë përzgjedhur çështjet për të dy gjyqtarët. Kjo çështje më pas i është kaluar gjyqtarit F. K. në datën 17.11.2020 edhe në mënyrë elektronike (veprimet në RIV me numër rendor ***).

Qëndrimi i çështjes në emrin tim si gjyqtar për periudhën 29.9.2020 – 17.11.2020 nuk përbën shkelje të parimit të anësisë si gjyqtar dhe as konflikt interesi. Ju sqaroj se në gjykatën e apelit, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, çështjet nuk i shkojnë gjyqtarit relator që në momentin e regjistrimit të saj. Deri në datën 5.11.2017, pa hyrë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile bërë me ligjin nr. 38/2017, në mbështetje të nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile data dhe ora e gjykimit caktohej nga kryetari i gjykatës.

Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, bërë me ligjin nr. 38/2017, duke filluar nga data 5.11.2017 data e gjykimit caktohet nga relatori, referuar nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Për shkak të natyrës dhe ngarkesës së punës në gjykatën e apelit ritheksoj se çështjet e shortuara nuk i shkojnë me të parë gjyqtarit të përzgjedhur me short. Por, sekretaret gjyqësore dhe kancelarja janë udhëzuar nga të gjithë gjyqtarët që çështjet civile të nxirren për gjykim sipas radhës me rend nga çështja e regjistruar më herët. Përrjashtim kanë bërë vetëm çështjet, për të cilat Kodi i Procedurës Civile me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 38/2017, caktoi afate gjykimi (15 ditë, 30 ditë, 60 ditë) ose rastet kur gjykata e apelit vepronte si gjykatë e shkallës së parë, për të cilat kryetari i gjykatës me urdhrin nr. ***, datë 20.9.2019, pasi ka marrë mendimin e gjithë gjyqtarëve, ka urdhëruar që do t'i çohen relatorit menjëherë sapo shortohen. Të gjitha çështjet e tjera qëndrojnë në arkivën e gjykatës i dorëzohen gjyqtarit për studim rreth 10 ditë para seancës së parë gjyqësore.

Çështja që ju keni parashtruar si shkelje e parimit të paanësisë, referuar objektit të gjykimit, nuk përfshihet në çështjet që unë kam detyrimin t'i shoh dhe të caktoj datën e gjykimit që në momentin e shortimit. Në këtë rast, do të njihesha fizikisht me dosjen rreth 10 ditë para seancës gjyqësore për t'u lexuar dhe në atë moment do të vlerësoheshin ekzistenca ose jo e rasteve të parashikuara në nenet 72-73 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo çështje nuk është lexuar paraprakisht nga ana ime, nuk është vënë në lëvizje nga unë dhe as i është caktuar datë gjykimi, nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga ndërgjyqësit për t'u gjykuar me procedurë të përsheptuar që unë të vija në dijeni për palët ndaj vlerësuar se nuk kisha se si të vlerësoja rrethanat e mundshme të konfliktit të interesit.

Sa i përket gjetjeve tuaja se kjo çështje rezultonte në emrin tim edhe në datën 7.12.2020, kjo rrethanë përbën çështje teknike të sistemit, i cili për shumë kohë ka shfaqur probleme të ndryshme për shkak se nuk ka pasur asnjë mirëmbajtës të kontraktuar qoftë nga Ministria e Drejtësisë qoftë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Duke marrë shkas edhe nga ky konstatimi juaj, në datën 11.1.2021, IT-ja i gjykatës së apelit i është drejtuar mirëmbajtësit të kontraktuar nga KLGJ-ja për çështjet e sistemit dhe ky i fundit, në datën 15.1.2021, ka ndrequr atë çka nuk është rakorduar mes sistemit të brendshëm ICMIS dhe asaj që shfaqet për publikun në webin www.gjykata.gov.al

Bashkëngjitur po ju paraqes si provë të gjithë praktikën dokumentare në mbështetje të shpjegimeve të mia.

Ndonëse i qëndroj në mënyrë kategorike argumentit se nuk kam pasur konflikt interesi në këtë rast, në kohën e përgatitjes së këtyre shpjegimeve pas barrës së provës së ngarkuar nga Komisioni, nga studimi për dhënien e këtyre shpjegimeve të të dhënave të subjektit tregtar në faqen zyrtare të QKB-së, nga ekstrakti historik i shoqërisë vërej se në datën 12.7.2019 është depozituar kontrata e shitjes 100% së kuotave nga ortaku i vetëm A. K. tek A. Ç. (personi i lidhur nuk rezulton më ortak/administrator) dhe po në datën 19.11.2019, ortaku A. Ç. i shet kuotat tek E. Ll., i cili bëhet ortak i vetëm dhe administrator gjithashtu”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

292. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e dorëzuara në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, duke i vlerësuar me paanësi dhe objektivitet, arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm ndryshimin e të dhënave në sistemin e Gjykatës së Apelit Durrës, pasi u kërkua informacion nga Komisioni në lidhje me çështjen në fjalë.

293. Në vijim, duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e pranuar prej subjektit të rivlerësimit që konsistojnë në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara dhe, nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje, të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura në vlerësimin e çështjes në tërësi, arrin në përfundimin se

- subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *Vetting* lidhur me burimin e krijimit të pasurive dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germet “a” “b” dhe “c”, dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016

- në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut te drejtësia pasi veprimet e subjektit të rivlerësimit, referuar sa analizuar në pikat 2 , 4 dhe 7 të këtij vendimi, përbëjnë zgjedhje të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 26.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku